



ANTEA CEMENT SH.A.

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR DHE
PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE MË DHE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021

Përmbajtja

INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	a-g
OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....	i-iii
PASQYRA INDIVIDUALE E FITIM HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE.....	1
PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR.....	2
PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	3
PASQYRA INDIVIDUALE E LËVIZJES SË FLUKSEVE MONETARE.....	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	5
2. MJEDISI OPERACIONAL.....	5
3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL.....	5
4. GJYKIMET DHE VLERESIMET E RËNDËSISHME KONTABËL, NE APLIKIMIN E POLITIKAVE KONTABËL.....	16
5. ADAPTIMI I INTERPRETIMEVE DHE STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA.....	17
6. INTERPRETIME TË REJA TË KONTABILITETIT.....	18
7. TË ARDHURAT.....	19
8. KOSTO E SHITJEVE.....	20
9. TË ARDHURA TË TJERA OPERACIONALE.....	20
10. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE.....	21
11. SHPENZIME SHITJE DHE MARKETINGU.....	21
12. SHPENZIME ADMINISTRATIVE.....	21
13. SHPENZIME PERSONELI.....	21
14. SHPENZIMET FINANCIARE, NETO.....	22
15. TE ARDHURA NGA DIVIDENDI.....	22
16. TATIMI MBI FITIMIN.....	22
17. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE.....	24
18. AKTIVET AFATGJATA JO-MATERIALE.....	25
19. AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI.....	25
20. INVESTIMET NË FILIALE.....	26
21. AKTIVE TE TJERA AFAT-GJATA.....	26
22. INVENTARI.....	26
23. LLOGARI TË ARKËTUESHME.....	27
24. TË TJERA TË ARKËTUESHME.....	28
25. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË TË TYRE.....	28
26. KAPITALI I NËNSHKRUAR DHE I PAGUAR.....	28
27. PLANI STIMULUES AFATGJATË.....	28
28. HUAMARRJET.....	30
29. RAKORDIMI I DETYRIMEVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE.....	32
30. LLOGARI TË PAGUESHME.....	32
31. TË TJERA TË PAGUESHME.....	32
32. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA.....	33
33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT.....	35
34. VLERA E DREJTË.....	38
35. MANAXHIMI I KAPITALIT.....	39
36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA.....	40
37. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT.....	40

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

INFORMACION I SHOQËRISË

ANTEA Cement Sh.A. është një investim me standardet më të larta të zbatuara përsa i përket ndërtimit të fabrikës së saj dhe ushtrimit të veprimtarisë së saj në Shqipëri, me një vlerë totale investimi që tejkalon vlerën prej 200 milion euro. Shoqëria kontrollohet nga ALVACIM LTD, e cila zotëron 100% aksionet e Shoqërisë. Shoqëria Mëmë kryesore është TITAN Cement International S.A. (në vijim referuar si **Grupi TITAN**).

Qeveria Shqiptare i akordoi ANTEA Cement të drejtën për përdorimin e tokës dhe shfrytëzimin e karrierve respektive, për 99 vjet. Fabrika u ndërtua nga CBMI Construction Co, një shoqëri Kineze, e cila e ushtron veprimtarinë në fushën e ndërtimit me mbikëqyrjen nga ana e Grupit TITAN, i cili ka zbatuar standardet më të larta të sigurisë, projekti është zbatuar në kohë, brenda buxhetit të parashikuar, si dhe me zero aksidente.

ANTEA Cement ka një kapacitet prodhimi prej 1.4 milion ton çimento në vit dhe 3.300 ton klinker në ditë. Fabrika ndodhet në Boka e Kuqe, Borizanë, Krujë, e cila është 50 km larg nga Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë.

Shoqëria ka dy filiale, në pronësi të plotë (100%), si më poshtë:

ALBA CEMENTO Sh.p.k.

ALBA CEMENTO Sh.p.k. ka në pronësi dhe operon një terminal për çimento në Tiranë. Shoqëria përgatit dhe dorëzon pasqyrat e saj financiare, në përputhje me legjislacionin përkatës në Shqipëri. Të gjitha të ardhurat që Shoqëria gjeneron vijnë si pasojë e ofrimit të shërbimeve logjistike.

CEMENTI ANTEA SRL – Itali

Aktiviteti kryesor i filialit është tregtimi i çimentos së eksportuar nga ANTEA Cement, përmes një terminali të marrë me qira në Ortona, Itali. Shoqëria shet çimenton e eksportuar nga Shqipëria në tregun Italian dhe të ardhurat e saj kryesore burojnë nga kjo veprimtari.

Informacioni i mëposhtëm jepet në përputhje me parashikimet dhe kërkesat e ligjit "Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar" Nr. 25/2018, datë 10.05.2018.

PËRSHKRIMI I BIZNESIT

ANTEA Cement është një nga prodhuesit kryesorë të çimentos në Shqipëri, e cila operon me një fabrikë që është në gjëndje të mbulojë të gjithë procesin teknologjik të shndërrimit nga lëndë të parë në produktin përfundimtar. Përmes teknologjisë së vendosur në fabrikën e saj, Shoqëria mund të prodhojë si klinker ashtu dhe çimento.

Klinkeri është një gjysëm - produkt që prodhohet nga Shoqëria, i cili mund të përdoret më tej nga ANTEA Cement për prodhimin e çimentos, ose mund të shitet tek Shoqëritë e tjera për prodhimin e çimentos, ndërsa produkti përfundimtar është çimento e llojeve të ndryshme.

Shoqëria shet produktin e saj në tregun e brendshëm, si dhe e eksporton atë në tregun ndërkombëtar.

RAPORTI MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

ANTEA Cement

ANTEA Cement (në vijim referuar si "ANTEA" ose "Shoqëria") arriti një rezultat të qëndrueshëm në 2021, pavarësisht pasigurisë së shkaktuar nga pandemia e COVID-19 dhe kostove në rritje të energjisë. Performanca e Shoqërisë u mbështet nga përmirësimi i volumeve të shitjes në tregjet vendase ashtu edhe në ato të eksportit mbi të cilat Shoqëria e mbështeti rezultatin e vet.

Në të njëjtën kohë, ANTEA është e përqëndruar në objektivat e veta afatgjata për të patur një rritje të balancuar, të përgjegjshme dhe të qëndrueshme, si një organizatë që ka në qëllimin e saj si ndryshimin ashtu dhe inovacionin me një ritëm të lartë.

Më poshtë jepen disa nga treguesit kryesorë financiarë, duke krahasuar periudhën aktuale të raportimit me periudhën e mëparshme të raportimit.

INFORMACION I PERGJITHSHEM (VAZHDIM) RAPORTI MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË (VAZHDIM)

Treguesit Financiar të performancës Vlerat në 000 LEKË	ANTEA Cement - Individuale	
	2021	2020
Të ardhurat	8,975,445	7,485,974
Fitimi operativ para interesave dhe taksave	1,503,830	1,775,528
EBITDA (fitimet para interesave, taksave, amortizimit dhe zhvlerësimit)	2,450,385	2,715,937
Fitimi para tatimit	1,208,491	1,043,796
Fitimi neto për vitin	1,006,192	849,080

Të ardhurat e Shoqërisë gjatë vitit arritën në vlerën **8,975,445 mijë lekë** me një rritje prej 20% ose **1,489,471 mijë lekë** krahasuar me vitin paraardhës, kryesisht prej kërkesës në rritje për produktet e Shoqërisë. Ndarja e detajuar e të ardhurave të Shoqërisë është e disponueshme në shënimin 7 të pasqyrave financiare.

Shoqëria mbajti aktivitetet e saj të eksportit në nivele të ngjashme krahasuar me vitet e mëparshme me pjesëmarrje prej 67% / 33% kundrejt 67% / 33% në vitin e kaluar. Tregjet kryesore ku Shoqëria eksporton janë vendet fqinje dhe rajoni i Mesdheut.

Fitimi operativ para interesit dhe taksave arriti në vlerën **1,503,830 mijë lekë**, duke shënuar një rënie me 15% ose **271,698 mijë lekë** krahasuar me një vit më parë, i ndikuar kryesisht nga rritja a ndjeshme e kostove të lëndës djegëse dhe energjisë elektrike në gjysmën e dytë të vitit 2021. Po kështu, EBITDA e shoqërisë arriti në vlerën **2,450,385 mijë lekë**, duke shënuar një rënie me 10% ose **265,552 mijë lekë** kundrejt vitit të kaluar, siç tregohet edhe në shënimin 35 të pasqyrave financiare.

Fitimi para tatimit për vitin 2021 arriti në vlerën **1,208,491 mijë lekë**, më i lartë se viti i kaluar me një rritje prej **164,695 mijë lekë**, i ndikuar kryesisht nga ulja e kostove financiare të Shoqërisë dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Më shumë detaje jepen në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

Rezultatet e mësipërme të operacioneve, të shoqëruara me lëvizjen në kapitalin qarkullues të Shoqërisë, rezultuan në flukset neto të mjeteve monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative, në vlerën **1,962,566 mijë lekë**, e cila ishte **170,364 mijë lekë** më pak në krahasim me vitin paraardhës. Shoqëria i ka përdorur këto burime për të investuar në blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale, në vlerën **170,684 mijë lekë** dhe gjithashtu ka përdorur fluksin neto të parasë në shlyerjen e huamarrjeve në vlerën **1,505,280 mijë lekë**, gjatë periudhës. Shoqëria e mbylli vitin financiar në një gjendje të kënaqshme dhe të qëndrueshme likuiditeti.

Për sa i përket performancës teknike, funksionimi i linjës së prodhimit gjatë vitit 2021 ka vijuar të ndjekë nivelin e kërkesës për produktin e Shoqërisë, duke u përqëndruar ndërkohë në optimizimin e inventarëve dhe kapitalit qarkullues gjatë vitit. Linja e prodhimit ka funksionuar në nivele shumë të larta besueshmërie, duke siguruar lëvizimin në kohë të produkteve, si në tregjet e brendshme ashtu edhe në tregjet e eksporteve, veçanërisht gjatë periudhave kur ka patur kërkesë të lartë, duke mundësuar shfrytëzimin e të gjitha oportuniteteve në treg.

Për sa i përket Shëndetit dhe Sigurisë, Shoqëria ka siguruar që kërkesat ligjore si dhe të gjitha udhëzimet e vendosura nga Grupi TITAN të ndiqen duke zbatuar praktikën më të mira për të zhvilluar më tej performancën e përgjithshme. Prandaj, trajnimet janë të rëndësishme dhe efektive, pasi ato edukojnë punonjësit për procedurat, praktikën dhe sjelljen e duhur në vendin e punës për të parandaluar dëmtime të mundshme dhe sëmundje ose ndotje nga higjiena e papërshtatshme. Çdo vit Shoqëria ka një program të përshtatshëm për sigurinë dhe shëndetin në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin dhe të komunikojë praktikën e azhuruara të sigurisë dhe shëndetit të punonjësve. Në vitin 2021 punonjësit tanë, duke përfshirë nënkontraktuesit, kishin **3,037.5 orë** trajnime vetëm në temat / çështjet e Shëndetit dhe Sigurisë. Përkundër vitit të dytë të vështirë në lidhje me situatën pandemike, performanca e sigurisë dhe shëndetit ka qënë shumë skrupuloze në zbatimin e rregullave të reja të Covid-19 për të menaxhuar dhe izoluar rastet e mundshme të prekura/dyshuara me Covid-19 midis punonjësve dhe nën-kontraktorëve.

Gjithashtu, ANTEA ka dhuruar çimento për disa bashki të ndryshme në Shqipëri, për t'i ndihmuar ata në projektet e tyre civile lidhur me rrugët e prishura dhe rehabilitimin e tyre, restaurimet / ndërtimet e shtëpive dhe shkollave lokale. Për më tepër, ANTEA vazhdon të angazhohet në promovimin e standardeve dhe praktikave më të mira në vend mbi PSK-në, duke organizuar konferenca dhe takime me institucione, universitete, organizata dhe OJQ, si dhe duke udhëhequr qasjen mbi PSK-në dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Performanca mjedisore e ANTEA-s monitorohet dhe rishikohet gjatë gjithë vitit. Rishikimi trajton në përputhje me rrethanat dhe në kohë të gjitha çështjet materiale të veprimtarive tona. Që prej fillimit të funksionimit, ANTEA ka ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me sistemin e menaxhimit mjedisor ISO 14001, të çertifikuar nga një palë e tretë e pavarur. Certifikimi mbulon cilësinë dhe përshtatshmërinë e të gjitha sistemeve të aplikueshme, të cilat zbatohen për të kontrolluar dhe reduktuar emëtimet në ajër, rehabilitimin e karrierave dhe aspektet mbi peisazhin, aspektet mbi burimet nëntokësore, pusët dhe ujërat e zeza, mbetjet e lëngshme dhe të ngurta, burimet natyrore dhe konsumin e energjisë, zhurmën e aspekte të tjera mjedisore. Shoqëria operon plotësisht në përputhje me ligjet dhe legjislacionin në fuqi, në këtë drejtim.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM) RAPORTI MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË (VAZHDIM)

ANTEA vazhdimisht përmirëson performancën mjedisore, duke i përqendruar përpjekjet në ndikimin rreth ndryshimeve klimatike, përdorimin me përgjegjësi të burimeve natyrore, duke përmirësuar efikasitetin tonë të energjisë, si dhe duke kontribuar në ekonominë qarkulluese.

Punonjësit janë pika thelbësore, lidhur me gjithçka që ne bëjmë. Burimet njerëzore janë aseti që drejton performancën dhe efikasitetin e Shoqërisë. Shoqëria jonë ka si përparësi të sigurojë një marrëdhënie të fortë punëdhënës – punonjës, bazuar në besimin dhe konsistencën e ndërsjelltë në vlerat dhe parimet e korporatave. Ne ofrojmë një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe të denjë, duke respektuar kushtet e shëndetit dhe sigurisë dhe të drejtat e njeriut.

Struktura e Shëndetit dhe Mirëqenies TITAN u zhvillua duke mbuluar katër dimensione të shëndetit dhe mirëqenies – fizike, mendore, sociale dhe financiare. Për të ndihmuar në rritjen e shëndetit dhe mirëqenies mendore dhe emocionale të njerëzve të tij, TITAN zgjeroni Programin e Asistencës së Punonjësve (PAP), një shërbim mbështetës këshillues i ofruar për të gjithë punonjësit dhe familjet e tyre, duke vënë në dispozicion këshilla të ekspertëve për çështje personale, familjare ose të lidhura me punën. Shoqëria vazhdon të ofrojë Planin Mjekësor, të Sigurimit të Jetës dhe aksidenteve në Punë për të gjithë punonjësit e saj.

Antea Cement demonstroi përkushtimin e saj drejt promovimeve dhe përmirësimit të procesit të mirë të përgjegjësisë, të manifestuar përmes komunikimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë me punonjësit tanë dhe proceset e vendimmarrjes. Shoqëria ka një zbatim të suksesshëm të Standardit të Përgjegjshmërisë Sociale 8000: 2014 (SA8000: 2014) duke zhvilluar, mirëmbajtur dhe zbatuar praktika sociale në vendin e punës, duke ofruar mundësi të barabarta, shumëllojshmëri vlerash që kontribuojnë në efektivitet dhe duke bërë përpjekje të mëdha për rekrutimin e kandidatëve të kualifikuar, duke mos lejuar asnjë formë diskriminimi në lidhje me gjininë, racat, kombësinë, fenë dhe familjen. Mekanizmat e kërkuar mbahen në vend për të siguruar pajtueshmërinë me këto kërkesa.

Më 31 dhjetor 2021, numri i punonjësve të ANTEA Cement ishte **189**. Gjatë vitit 2021 shpenzimet për përfitimet e punonjësve arritën në vlerën **420,857 mijë lekë**, sikurse shpjegohet në Shënimin 13 të Pasqyrave Financiare.

Ne jemi të përkushtuar për një standard më të lartë të zhvillimit të njerëzve. Edhe pse viti 2021 ishte një vit i vështirë, ne ia dolëm të përballonim situatën e krijuar nga Covid-19 duke informuar dhe organizuar ambientin e punës për të pasur kushte të sigurta pune. ANTEA është e përkushtuar për të pajisur punonjësit me aftësitë, kompetencat dhe mendësitë që u nevojiten për të qenë të suksesshëm në një mjedis të larmishëm dhe gjithëpërfshirës. Gjatë vitit 2021, pavarësisht vështirësive të situatës pandemike, ne vazhduam të kontribuojmë në zhvillimin e punonjësve tanë, duke kaluar nga mënyra tradicionale në trajnime online ose të kombinuara duke respektuar protokollin COVID-19. Orët totale të trajnimit për vitin 2021 ishin 5,416.

a) Rreziqet e biznesit

Detyrimet kryesore financiare të Shoqërisë përfshijnë hua që mbartin interes, detyrime të tjera dhe detyrime tregtare. Synimi kryesor i këtyre instrumentëve financiarë është që të sigurohet financimi i veprimtarisë së Shoqërisë. Shoqëria zotëron aktive financiare, siç janë të arkëtueshmet tregtare dhe arkëtime të tjera, para dhe ekuivalentë të parasë, të cilat burojnë nga veprimtaria e Shoqërisë. Rreziqet kryesore, që vijnë nga instrumentet financiare të Shoqërisë janë Rreziku i normave të interesit, Rreziku i kursit të këmbimit, Rreziku i Likuiditetit, Rreziku i kreditit. Politikat e zbatuara nga niveli drejtues i Shoqërisë, për administrimin e të gjithë këtyre risqeve, janë të përmbledhura në Shënimin 33, të Pasqyrave Financiare.

b) Aktiviteti i kërkimit dhe zhvillimit të Shoqërisë

Gjatë vitit 2021, Shoqëria nuk ka kryer asnjë aktivitet në lidhje me kërkimin dhe zhvillimin.

c) Blerja e aksioneve të veta

Shoqëria nuk zotëron aksione të Shoqërisë dhe nuk ka pasur transaksione të tilla në vitin 2021.

d) Degët e Shoqërisë

Shoqëria ka dy shoqëri bija të zotëruara në 100% siç u shpjegua më lart. Përveç këtyre dy shoqërive, Shoqëria nuk ka degë apo filiale të tjera.

e) Politikat dhe objektivi i administrimit të riskut financiar, ekspozimi i Shoqërisë ndaj risqeve financiare & sasive të riskut

INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM) RAPORTI MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË (VAZHDIM)

Politikat dhe Objektivat për administrimin e rreziqeve financiare, si dhe sasitë përkatëse, përfshihen në shënimet 4 dhe 33, të Pasqyrave Financiare.

f) OBJEKTIVAT E SHOQËRISË PËR VITIN 2022

Shoqëria ka si synim të arrijë objektivat e mëposhtme, për vitin 2022

- Rritjen e efektivitetit të performancës industriale;
- Vazhdimin e shërbimit të klientëve të saj me produktet e veta si në tregjet e brendshme ashtu dhe në ato të eksportit, si dhe të qenit e gatshme për të plotësuar çdo lloj kërkesë që mund të paraqitet në tregjet që Shoqëria operon.
- Vazhdimësinë e rezultateve aktuale financiare dhe identifikimin e fushave të tjera që mund të kontribuojnë në rritjen e rezultateve të veta ashtu si dhe mirëmenaxhimin e kostove fikse.

RAPORTI I DREJTIMIT TË BRENDSHËM

a) Qeverisja e Korporatës

Shoqëria është krijuar si një Shoqëri Aksionere, në përputhje me Ligjin Tregtar të Republikës së Shqipërisë dhe ka një sistem qeverisjeje me dy nivele, i cili është si më poshtë:

- Këshilli Mbikqyrës
- Administratori / Drejtori i Përgjithshëm

Me datën 31 dhjetor 2021, Këshilli Mbikqyrës përbëhej si më poshtë:

- Z. Ioannis Paniaras, Kryetar i Këshillit Mbikqyrës
- Z. Fokion Tasoulas, Anëtar i Këshillit Mbikqyrës
- Z. Christos Panagopoulos, Anëtar i Këshillit Mbikqyrës,
- Z. Loukas Petkidis, Anëtar i Këshillit Mbikqyrës
- Z. Grigorios Dikaios, Anëtar i Këshillit Mbikqyrës

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës sjellin në bord një përvojë të vlefshme nga fusha të ndryshme, që përfshijnë ekspertiza në fushat industriale, tregtare, si dhe ato financiare.

Këshilli Mbikqyrës emëron Administratorin / Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë.

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë është Z. Mario Bracci.

b) Menaxhimi i risqeve dhe mundësive

ANTEA Cement zbaton një Sistem Menaxhimi të Integruar (SMI), i cili përbëhet nga tre sisteme menaxhimi dhe një standard, konkretisht:

- OSO 45001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë
- ISO 14001:2015 për Mjedisin
- ISO 9001 për Cilësinë
- SA 8000:2014 për Përgjegjësinë Sociale

Ekipi i menaxhimit i ANTEA Cement vlerëson rreziqet sociale, mjedisore, drejtuese dhe financiare, me të cilat Shoqëria mund të përballlet në kuadrin e sfidave të vendit, rajonit dhe më tej. Shoqëria administron rreziqet përmes:

- Kontrollëve dhe sistemeve të brendshme, në përputhje me kërkesat e Sistemeve të Menaxhimit;
- Krijimit të komiteteve të ndryshme në Shoqëri, për të adresuar sfida dhe çështje të ndryshme.

Pranë ANTEA Cement janë krijuar Komitetet e mëposhtme, për të trajtuar sfida dhe çështje të ndryshme:

INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM) RAPORTI I DREJTIMIT TË BRENDSHËM (VAZHDIM)

Komiteti i Cilësisë:

Niveli drejtues i Shoqërisë është i përfshirë në Sistemin e Cilësisë përmes Komitetit të Cilësisë.

Këto janë përgjegjësitë e Komitetit të Cilësisë:

- Vendosja e Politikave të Cilësisë, të Shoqërisë;
- Miratimi i dokumenteve të sistemit të cilësisë;
- Kryerja e kontrolleve të brendshme të cilësisë;
- Kryerja e rishikimeve të sistemit të cilësisë;
- Vendosja e objektivave të cilësisë;

Komiteti i Mjedisit:

Bordi i Mjedisit është përgjegjës për të identifikuar aspektet mjedisore, përcakton situatat emergjente dhe nevojën për përgatitjen e planeve të emergjencës dhe rishikimin në bazë vjetore të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit, etj.

Komiteti Qëndror i Shëndetit dhe Sigurisë:

Komiteti Qëndror i Shëndetit dhe Sigurisë i ANTEA-s ofron udhëzime strategjike dhe taktike për përmirësimin e nismave në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në Fabrikën ANTEA. Ai krijon procese efektive të biznesit për të promovuar zbatimin e plotë të Politikave të Shëndetit dhe Sigurisë së Grupit TITAN. Anëtarët e Komitetit Qendror duhet të tregojnë udhëheqje të dukshme, përkushtim personal, mbështetje aktive, përgjegjshmëri të veprimeve dhe ndjekje në kohë të të gjitha programeve të sigurisë.

Komiteti i Përgjegjshmërisë Sociale:

Fabrika ka caktuar gjithashtu një Bord të Përgjegjshmërisë Sociale, i cili është përgjegjës për të identifikuar çështjet e përgjegjshmërisë sociale, përcaktuar veprimet e kërkuara parandaluese ose korrigjuese dhe rishikuar në bazë vjetore sistemin e menaxhimit të përgjegjshmërisë sociale etj.

Shoqëria është trajnuar gjerësisht në fushat më delikate si, lufta kundër mitmarrjes, korrupsionit, si edhe sanksionet dhe ka përfshirë gjerësisht në marrëdhëniet e saj kontraktuale me furnizuesit, klientët dhe partnerët dispozita përkatëse për të shmangur implikimet e paligjshme. Për më tepër, është miratuar një politikë e konfliktit të interesit dhe është krijuar një Komitet përgjegjës për ndjekjen e rasteve të konfliktit të mundshëm të interesit, me pjesëmarrjen e nivelit të lartë drejtues të Shoqërisë.

Në vijim të ndryshimeve të fundit në legjislacionin e brendshëm, Shoqëria ka zgjedhur dhe formalizuar Njësinë Përgjegjëse, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar për Informatorët. Kjo Njësi ka zhvilluar disa trajnime dhe ka shpërndarë materialet e nevojshme për punonjësit, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për të drejtat dhe detyrimet e tyre në rast se vihen në dijeni për një rast korrupsioni.

Per me tepër disa nga iniciativat e shtuara në vitin 2021 me qëllim zgjerimin ndikimin mbi punonjësit tanë janë si me poshte:

- **Platforma e etikës-**

- **Programi i Ndihmës së Punonjësve të TITAN (PNP)**, pjesë e Grupit TITAN programi për "Shëndet dhe Mirëqenie" synon të mbështesë më tej shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve të Grupit TITAN dhe anëtarëve të familjes, kudo dhe kurdo që të jetë e nevojshme.

c) Vlerat e ANTEA-s

Vlerat e ANTEA-s burojnë drejtpërdrejt nga parimet, besimet dhe vizioni, që prej krijimit të saj në vitin 2006. Ato janë elementet thelbësore, në përputhje me kulturën dhe shpirtin e familjes së TITAN, duke siguruar themelet e veprimtarive dhe zhvillimit të Grupit. ANTEA Cement Sh.A. është e angazhuar të krijojë vlera për punonjësit e saj, komunitetin lokal, furnizuesit dhe klientët e saj, përmes forcimit të vlerave thelbësore, duke aplikuar praktikat etike të biznesit, duke pasur një komunikim të hapur dhe të vazhdueshëm me të gjitha palët e interesuara dhe trajtuar çështjet e tyre më materiale, në kohë dhe në mënyrën e duhur. Megjithatë mjedisi ku Shoqëria ushtron aktivitetin ka sfidat e veta, ANTEA përpiqet të jetë një Shoqëri përgjegjëse, përmes identifikimit të ndikimit në shoqëri dhe ndërmarrjes së veprimeve për krijimin e vlerës për palët e saj të interesuara, duke minimizuar efektet e kundërta, duke rritur ndërkohë mirëqenien e punonjësve të saj, komunitetet vendase dhe partnerët e biznesit.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM) RAPORTI I DREJTIMIT TË BRENDSHËM (VAZHDIM)

Më poshtë janë paraqitur vlerat e Shoqërisë:

- **Integriteti:** Praktikë etike të biznesit; transparenca; komunikimi i hapur
- **Njohuria:** Përmirësimi i bazës së njohurive; aftësi në çdo funksion; përsosmëri në kompetencat thelbësore
- **Vlera për klientin:** Parashikimi i nevojave të klientit; zgjidhje inovative; cilësi e lartë e produkteve dhe shërbimeve
- **Dorëzimi i rezultateve:** Vlera e aksionerit; objektivat e qarta; standarde të larta
- **Përmirësimi i vazhdueshëm:** Organizimi i të mësuarit; gatishmëria për të ndryshuar; sfida
- **Përgjegjësia Sociale e Korporatave:** Siguria në plan të parë; zhvillimi i qëndrueshëm; angazhimi i palëve të interesit

Duke vepruar në të njëjtën linjë me Grupin TITAN, që synon të rritet si një prodhues çimentoje multi-rajonal, prodhues çimentoje i integruar vertikalisht, duke kombinuar shpirtin sipërmarrës dhe përsosmërinë operacionale në lidhje me punonjësit, shoqërinë dhe mjedisin e saj, ANTEA zbaton objektivat e Grupit TITAN, të përkthyer në katër përparësi strategjike:

- **Shumëllojshmëria gjeografike:** Zgjerimi i marrëdhënieve të biznesit të Shoqërisë, përmes blerjeve dhe zhvillimeve në fushën e mjedisit, në tregjet e reja tërheqëse;
- **Integrimi vertikal:** Zgjerimi i Shoqërisë në zona të tjera të produkteve, në zinxhirin e vlerës së materialit çimento;
- **Përmirësimi i vazhdueshëm konkurrues:** Implementimi i efikasitetit të ri për të ulur kostot dhe konkurruar në mënyrë më efektive;
- **Përqëndrimi në kapitalin njerëzor dhe Përgjegjësinë Sociale të Korporatës:** Zhvillimi i punonjësve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve të mira të Shoqërisë me të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Çështje Materiale ANTEA me horizontin 2025

Sipas rezultateve të Vlerësimit të Materialitetit ANTEA, ne do të trajtojmë dhjetë çështje materiale në përputhje me SDG-të e OKB-së 2030, të gjitha të mbështetura nga qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit.

Nëpërmjet këtij procesi, ne synojmë të ndërtojmë më tej marrëdhëniet tona të besuara dhe të krijojmë vlera të përbashkëta. Objektiva të qarta janë vendosur në vlerësimin e materialitetit të vitit 2020, pas procesit të hartuar nga Grupi Titan. Angazhimi i punonjësve; Zhvillimi dhe mirëqenia e vazhdueshme; Mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm i punës për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit; Kënaqësia e konsumatorëve; Mirëqeverisja, transparenca dhe etika e biznesit, Çështjet materiale të menaxhimit të mjedisit mbetën në krye të listës së çështjeve materiale të identifikuara.

Çështje Materiale ANTEA me horizontin 2025	
1	Angazhimi i punonjësve, zhvillimi i vazhdueshëm dhe mirëqenia
2	Mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm pune për punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit
3	Kënaqësia e konsumatorëve
4	Qeverisja e mirë, transparenca dhe etika e biznesit
5	Menaxhimi i Mjedisit
6	Zinxhiri i furnizimit i përgjegjshëm, i besueshëm dhe i qëndrueshëm
7	Ndryshimet Klimatike dhe Energjia
8	Inovacioni i modelit të biznesit
9	Mbështetja e mirëqenies së komuniteteve tona lokale
10	Marrëdhëniet dhe angazhimi me palët e interesuara

d) Kontrollat e brendshme dhe sistemet e menaxhimit të riskut, në lidhje me raportimin financiar

Këto janë elementët kryesorë të sistemit të kontroleve të brendshëm, të përdorura për të shmangur gabimet në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe për të siguruar një informacion të besueshëm financiar:

- Mekanizmi i sigurimit në lidhje me integritetin e pasqyrave financiare të Shoqërisë, përbëhet nga një kombinim i proceseve të vendosura të administrimit të riskut, aktiviteteve të zbatuara lidhur me kontrollin financiar, teknologjisë së informacionit të përdorur për informacionin dhe informacionit financiar të përgatitur, komunikuar dhe monitoruar. Shoqëria përgatit dhe rishikon në baza mujore të dhëna financiare dhe jo-financiare, të cilat analizohen nga niveli drejtues i Shoqërisë, në mënyrë periodike.
- Shoqëria përdor një paketë të plotë software SAP, për të monitoruar veprimet e saj operacionale dhe të kontabilitetit. Kjo zgjidhje softuerësh ofron mënyrën më të sigurt dhe të përparuar të regjistrimit dhe raportimit të të gjitha aktiviteteve të Shoqërisë, në mënyrë të saktë dhe korrekte.
- Shoqëria ka angazhuar auditorë të jashtëm, që të rishikojnë pasqyrat financiare të gjashtë-mujorit dhe të auditojnë pasqyrat financiare vjetore.

Të gjitha sa më sipër sigurojnë që pasqyrat financiare të Shoqërisë japin informacion të besueshëm dhe të saktë.

ANTEA CEMENT SH.A.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM) RAPORTIMI I PAGESAVE QË U BËHEN INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

Raporti i mëposhtëm është përgatitur në përputhje me nenin 21 të Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare Nr. 25/2018, datë 10.05.2018.

Tabela e mëposhtme tregon pagesat e kryera tek autoritetet shtetërore, sipas llojit të treguar të taksave ose kategorive.

Vlerat janë të prezantuara në 000'LEKË

Lloji i pagesës	2021	2020
• Të drejtat e prodhimit	-	-
• Pagesa e taksave sipas Legjislacionit të Aplikueshëm për Taksat		
- Tatimi mbi fitimin	273,534	199,263
- TVSH	145,083	201,523
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	59,269	58,421
- Taksa mbi të ardhurat personale	34,932	30,068
- Taksa e karbonit dhe e akcizës	366,486	282,177
- Taksat dhe tarifat lokale për autoritetet lokale	33,756	34,807
	59,359	49,741
• Renta Minerare	-	-
• Dividendët	-	-
• Pagesat për abonime, kërkim dhe prodhim	-	-
• Taksat dhe tarifat dhe pagesa të tjera që lidhen me licencat dhe konçesionet	-	-
• Pagesat për përmirësimet e infrastrukturës.	-	-
	-	-
TOTAL	972,419	856,000

Vlerat e mësipërme paraqesin pagesat aktuale të bëra nga Shoqëria gjatë vitit kalendarik që është mbyllur më 31 dhjetor 2021.

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerit të Antea Cement SH.A.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Antea Cement SH.A. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2021, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021;
- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera përfshijnë Raportin Vjetor, Raportin e Menaxhimit dhe Raportin e Pagesave të Kryera ndaj Institucioneve Shtetërore, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Regjistruar me Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit NUIS/NIPT: L92014010J
Regjistruar në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë me Vendim nr. 701, 03.07.2020 të Komitetit të Regjistrimit

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar të raportojmë këtë çështje. Ne nuk kemi diçka për të raportuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e drejtimit në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.



Ne komunikojmë me drejtimin, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.

Auditues Ligjor
Jonid Lamllari

25 shkurt 2022
Tiranë, Shqipëri



ANTEA CEMENT SH.A.

PASQYRA INDIVIDUALE E FITIM HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE (Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

	<i>Shënime</i>	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020
Të ardhurat	7	8,975,445	7,485,974
Kostot e shitjeve	8	(6,860,731)	(5,047,732)
Fitimi bruto		2,114,714	2,438,242
Të ardhura të tjera operacionale	9	56,365	69,970
Shpenzime të tjera operacionale	10	(15,385)	(72,287)
Shpenzime shitjeje dhe marketingu	11	(69,032)	(69,794)
Shpenzime administrative	12	(582,832)	(590,603)
Fitimi operativ para interesave dhe taksave		1,503,830	1,775,528
Të ardhura nga dividendi	15	12,478	9,802
(Shpenzime) financiare neto	14	(307,817)	(741,534)
Fitimi para tatimit		1,208,491	1,043,796
Tatimi mbi fitimin	16	(202,299)	(194,716)
Fitimi neto për vitin		1,006,192	849,080
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse pas tatimit mbi fitimin		1,006,192	849,080

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ANTEA CEMENT SH.A.

PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR (Shifrat në mijë Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020	
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	17	16,195,551	16,914,357
Aktive me të drejta përdorimi	19	120,356	127,327
Aktivitet afatgjata jomateriale	18	33,725	58,111
Investime në filiale	20	829,931	829,931
Të tjera aktive afatgjata	21	9,537	9,537
Totali Aktiveve Afatgjata	17,189,100	17,939,263	
Aktive afatshkurtra			
Inventari	22	2,124,747	1,491,641
Llogari të arkëtueshme	23	172,211	348,590
Të tjera të arkëtueshme	24	235,471	101,652
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	32B	226,218	229,386
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	25	996,423	814,873
Totali Aktiveve Afatshkurtra	3,755,070	2,986,142	
TOTALI I AKTIVEVE	20,944,170	20,925,405	
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali aksionar	26	10,686,510	10,686,510
Opsionet e Aksioneve	27	6,215	1,826
Humbje të akumuluar		(2,121,427)	(3,127,619)
Totali Kapitalit dhe Rezervave	8,571,298	7,560,717	
Detyrimet afatgjata			
Kredi dhe huamarrje me interes	28A	7,129,644	9,485,406
Detyrime për Qera	19	101,225	109,085
Detyrime tatimore të shtyra	16	1,117,892	1,154,065
Totali Detyrimeve Afatgjata	8,348,761	10,748,556	
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	30	1,557,357	870,470
Të tjera të pagueshme	31	148,099	112,149
Tatim Fitimi i pagueshëm		15,926	70,988
Kredi dhe huamarrje me interes	28B	1,918,497	1,278,413
Detyrime për Qera	19	20,698	22,257
Detyrime ndaj palëve të lidhura	32D	363,534	261,855
Totali Detyrimeve Afatshkurtra	4,024,111	2,616,132	
TOTAL I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE	20,944,170	20,925,405	

Këto pasqyra financiare individuale janë miratuar nga drejtimi i shoqërisë më 27 Janar 2022 dhe janë fimosur nga:

Mario Bracci

Drejtor i Përgjithshëm



Adrian Qirjako

Drejtor i Financës

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ANTEA CEMENT SH.A.

PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL (Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

	Kapital aksionar	Opsionet E Aksioneve	Humbjet e akumuluar	Totali
Më 1 janar 2020	10,686,510	-	(3,976,699)	6,709,811
Fitimi neto për vitin	-	-	849,080	849,080
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	849,080	849,080
Opsionet e bazuara në aksione (shënimi 27)	-	1,826	-	1,826
Më 31 dhjetor 2020	10,686,510	1,826	(3,127,619)	7,560,717
Fitimi neto për vitin	-	-	1,006,192	1,006,192
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	1,006,192	1,006,192
Opsionet e bazuara në aksione (shënimi 27)	-	4,389	-	4,389
Më 31 dhjetor 2021	10,686,510	6,215	(2,121,427)	8,571,298

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ANTEA CEMENT SH.A.

PASQYRA INDIVIDUALE E LËVIZJES SË FLUKSEVE MONETARE (Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	1,208,491	1,043,796
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet operative Korrigjuar për:		
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	17/19 922,169	916,484
Amortizim i aktiveve jomateriale	18 24,386	23,925
Provizione	24 -	(9,564)
(Fitim)/humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale	9/10 (327)	3,785
Ndryshime në provizionet e tjera	31 4,793	53,820
Te ardhura nga dividendët	(12,478)	(9,802)
Të ardhura nga interesi	14 (11)	(10)
Shpenzime për interesa	14 414,697	592,403
Opsionet ne Aksione	27 4,390	1,826
(Fitim)/Humbje nga diferenca e kursit të këmbimit	14 (119,779)	137,477
Fitimi operativ para ndryshimeve të kapitalit qarkullues	2,446,331	2,754,140
Ndryshime në kapitalin qarkullues		
(Rritje) / Rënie në inventarë	22 (633,106)	52,434
(Rritje) në llogaritë e arkëtueshme dhe në llogaritë e tjera të arkëtueshme	23,24,32 B (6,985)	(245,320)
Rritje në llogaritë e pagueshme dhe në llogaritë e tjera të pagueshme	30,31,32 D 806,190	94,830
Interesa të paguara	(382,129)	(323,901)
Tatim fitimi i paguar	(273,534)	(199,263)
Interesa të arkëtuara	11	10
Flukset neto të mjeteve monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	1,956,778	2,132,930
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet investuese		
Arkitime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	5,788	-
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	18 (170,684)	(154,543)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	19 -	(1,208)
Të ardhura nga dividendi	12,478	9,802
Flukset neto të mjeteve monetare të përdorura në aktivitetet investuese	(152,418)	(145,949)
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet financuese		
Fonde të marra nga huatë	1,097,564	11,121,317
Shlyerja e huave	(2,602,844)	(12,957,175)
Pagesa për qiratë	(37,704)	(37,738)
Pagesa për tarifa	(59,024)	(57,699)
Flukset neto të mjeteve monetare të përdorura në aktivitetet financuese	(1,602,008)	(1,931,295)
Rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	202,352	55,686
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre më 1 janar	25 814,873	769,028
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	(20,802)	(9,841)
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor	25 996,423	814,873

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Antea Cement SH.A. - ("Shoqëria") është themeluar në Republikën e Shqipërisë me adresë të regjistruar në "Rruga e Durrësit, Pallati prapa RING Center, Kati 1, 1001, PO Box 1746, Tiranë, Shqipëri". Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është prodhimi dhe tregtia e çimentos, rifuxho dhe të paketuara në thasë.

Aksioneri kryesor i Shoqërisë është ALVACIM Ltd, regjistruar në Qipro, i cili zoteron 100% të aksioneve të Shoqërisë (2020; ALVACIM Ltd 100% të aksioneve të Shoqërisë). Shoqëria mëmë kryesore është Titan Cement International S.A.

Këto pasqyra financiare individuale për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Shoqëria i mban të dhënat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare në pajtueshmëri me Ligjin mbi kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare nr. 25/2018, datë 05 maj 2018: "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare".

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2021 ishte 189; (31 dhjetor 2020: 189).

Monedha Prezantimit. Këto Pasqyra Financiare Individuale janë prezantuar në Lekë Shqiptar "LEK", nëse nuk është specifikuar ndryshe. Përveç kur thuhet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në LEK është rrumbullakosur në vlerën më të afërt në mijë Lekë.

2. MJEDISI OPERACIONAL

Gjatë vitit 2021 duke pasur parasysh pandeminë globale, Antea Cement mori masa paraprake për të mbajtur njerëzit e saj të shëndetshëm, për të siguruar që vendi i punës të ishte i sigurt dhe për të ruajtur nivele të mira likuiditeti për të mbështetur operacionet e saj. Për vitin 2021 ndikimi i Covid-19 në performancën e Antea rezultoi i ulët. Performanca operationale e Antea në vitin 2021 e kaloi atë të vitit 2020. Në vitin 2022 ka ende njëfarë pasigurie rreth evolucionit të pandemisë dhe rrjedhimisht ndikimit që mund të ketë në Antea Cement. Antea Cement vazhdon të monitorojë situatën, dhe pasiguritë përkatëse janë vlerësuar dhe përfshirë në buxhetin e saj duke marrë parasysh pritshmëritë makroekonomike, nismat stimuluese dhe zhvillimet e vaksinave. Antea Cement vazhdon të bëjë përpjekjet e saj më të mira për t'i mbajtur njerëzit e saj të shëndetshëm, duke siguruar që vendi i punës të jetë i sigurt dhe duke ruajtur likuiditet të bollshëm për të mbështetur operacionet e saj.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore të kontabilitetit të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

A. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Politikat kryesore të aplikuara për përgatitjen e pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kostos historike. Monedha e paraqitjes është lekë shqiptar ("LEK") duke qenë gjithashtu monedha funksionale dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosura në vlerën më të afërt ('000 lekë) përveçse kur thuhet ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve të rëndësishme kontabël. Kjo gjithashtu kërkon nga drejtimi i Shoqërisë që të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Zërat që kanë nevojë për gjykim të veçantë dhe kompleks si dhe zëra ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpjeguar në Shënimin 4.

Shoqëria ka dy filiale të zotëruara me 100%, Albacemento sh.p.k. me rezidencë dhe operacione në Shqipëri dhe Cementi Antea SRL me rezidencë dhe operacione në Itali.

Shoqëria përgatit dhe publikon pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF, në të cilën Shoqëria dhe filialet të saj janë të përfshira. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të publikuara dhe mund të merren në adresën: www.anteacement.com Në pasqyrat financiare të konsoliduara, filialet - janë ato shoqëri në të cilën grupi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ka një interes prej më shumë se gjysmën e pjesëtarëve me të drejtë vote ose ka fuqinë për të kontrolluar veprimtarinë e tyre - janë konsoliduar plotësisht.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

B. Investimet në filiale

Investimet në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta maten në kosto minus humbjen nga zhvlerësimi. Kostot e transaksionit kapitalizohen si pjesë e koston së investimit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së investimit si tarifatat profesionale për shërbimet ligjore, taksat e transferimit dhe shpenzimet e tjera të blerjes.

Kostoja fillestare e investimeve përfshin gjithashtu edhe pagesa që janë të kushtëzuara me rezultatet e ardhshme. Rivlerësimi i mëpasshëm i shumës së kushtëzuar të klasifikohet si pasiv financiar dhe të rregullohet kundrejt kostove të investimit.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera bartëse e një investimi mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse vlera e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë e vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerën e mbetur në përdorim) është më e vogël se sa është vlera kontabël, atëherë vlera kontabël zvogëlohet në vlerën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet në nxjerrje jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit të shitjes dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit. E njëjta vlen edhe nëse rezultati i nxjerrjes nga përdorimi është një hap poshtë nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose një pjesëmarrje e matur me kosto.

C. Përkthimi i monedhave të huaja

Monedha funksionale e Shoqërisë është monedhë e mjedisit primar ekonomik në të cilin vepron njësia ekonomike. Monedha funksionale e Shoqërisë është Leku shqiptar (Lekë), që është dhe monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë.

Transaksoionet dhe balancat. Aktivitetet dhe detyrimet monetare janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në fund të periudhës përkatëse të raportimit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale në fund të vitit financiar me normën e këmbimit valutor të fundit të vitit të Bankës së Shqipërisë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si të ardhura financiare apo shpenzime financiare.

Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor që lidhen me huamarrjet dhe mjetet monetare dhe ekuivalentet e parave të gatshme paraqiten në pasqyrën e të ardhurave brenda "të ardhurave ose kostove financiare "

Përkthimi me normat e fund vitit nuk zbatohet për zërat jo-monetarë që maten me kosto historike. Zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, duke përfshirë edhe investimet e kapitalit, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj janë regjistruar si pjesë e fitimit dhe humbjes nga vlera e drejtë.

D. Aktivitetet aftagjata materiale

Aktivitetet aftagjata materiale njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe/ose humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kjo kosto përfshin kostot e zëvendësimit të një pjese të tokës, ndërtesës, makinerive dhe pajisjeve dhe kostot e huamarrjes të projekteve aftagjata të ndërtimit nëqoftëse kriteret e njohjes përmbushen.

Shpenzimet e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitetit ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur kemi siguri që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kosto e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtjes ditore njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve të mëdha apo komponentët e aktiveve aftagjata materiale kapitalizohen dhe pjesa e zëvendësuar çregjistrohet.

Po kështu, kur kryhet një inspektim me vlerë të lartë, kostoja e tij njihet në vlerën kontabël të aktiveve aftagjata materiale nëse kriteret e njohjes përmbushen. Vlera aktuale e koston së pritshme për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve aftagjata materiale pas përdorimit të tyre është përfshirë në koston e aktivitetit përkatës, nëse kriteret e njohjes për një parashikim të tillë janë përmbushur.

Ndërhyrja në infrastrukturë që rrit jetën e dobishme të pronës, impianteve dhe pajisjeve, përmirëson operacionet ose optimizimin e koston, kapitalizohet në koston e tokës dhe ndërtimit dhe amortizohet gjatë jetës së dobishme të kësaj kategorie.

ANTEA CEMENT SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

D. Aktivet aftagjata materiale (Vazhdim)

Pjesët e këmbimit njihen si pjesë të aktiveve aftagjata materiale nëse përmbushin kriteret e mëposhtme: pjesët e këmbimit priten të përdoren në më shumë se një periudhë ushtrimore, kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme, kemi siguri që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me këto pjesë këmbimi do rrjedhin tek njësitë ekonomike, dhe vlera për njësi të pjesëve strategjike të këmbimit është e barabartë ose e kalon ekuivalentin prej 50 mijë Euro.

Amortizimi Toka nuk amortizohet. Amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve aftagjata materiale është llogaritur me metodën lineare duke shpërndarë koston dhe vlerën e mbetur të tyre sipas jetëgjatësisë ekonomike.

➤ Toka dhe përmirësimet	deri në 40 vjet
➤ Ndërtesa	deri në 40 vjet
➤ Makineri dhe pajisje	deri në 40 vjet
➤ Automjete	deri në 15 vjet
➤ Mobilje dhe pajisje, pajisje elektronike	deri në 10 vjet

Vlera e mbetur e një aktivi është shuma e vlerësuar që Shoqëria do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivit minus koston e vlerësuar për ta nxjerrë jashtë përdorimit, në qoftë se aktivi është tashmë në moshën dhe në kushtet e pritshme në fund të jetës së tij të dobishme. Vlera e mbetur e aktivit dhe jeta e dobishme rishikohen, dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe raportimi. Një aktiv aftagjatë material dhe çdo pjesë përbërëse e tij e rëndësishme të njohura fillimisht me kosto, ç'regjistrohet në rastin kur nxirret jashtë përdorimit, ose kur nuk priten të rrjedhin në shoqëri përfitime të ardhshme nga përdorimi ose nga shitja e tij. Çdo fitim ose humbje që vjen nga ç'regjistrimi i aktivit (llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktivit), përfshihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur aktivi ç'regjistrohet.

E. Aktive me të drejta përdorimi

Shoqëria mer me qira toka, zyra, pajisje dhe automjete të ndryshme. Kontratat mund të përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-qirasë. Nëse është kështu, Shoqëria bën përcaktimin në kontratë për komponentët e qirasë dhe jo-qirasë bazuar në çmimet e tyre relative të pavarura.

Aktivitet që rrjedhin nga një qira maten fillimisht mbi bazën e vlerës aktuale.

Matja fillestare e aktivitet me të drejtë përdorimi ROU përbëhet nga:

- Shuma e matjes fillestare të detyrimit të qirasë
- Cdo pagesë e qirasë bërë në ose para datës së fillimit, minus çdo zbritje të marrë nga qiraja
- Cdo kosto fillestare direkte, dhe
- Kostot e restaurimit

Aktivitet me të drejtë përdorimi në përgjithësi amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër të jetës së dobishme të aktivitet dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Shoqëria është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të ushtrojë një opsion blerjeje, aktivi i së drejtës së përdorimit amortizohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve bazë. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar si më poshtë:

➤ Toka dhe përmirësimet	deri në 40 vjet
➤ Ndërtesa	deri në 40 vjet
➤ Makineri dhe pajisje	deri në 20 vjet
➤ Automjete	deri në 15 vjet

** E drejta e përdorimit të tokës duhet të amortizohet pasi megjithëse toka ka një jetë të dobishme të pakufizuar, jeta e dobishme e të drejtës së përdorimit të tokës është e kufizuar nga kushtet e kontratës.*

Shoqëria paraqet aktive me të drejtë përdorimi ROU që nuk plotësojnë përkufizimin e Aktiveve të Investimit në llogarinë "prona, makineri dhe pajisje", në të njëjtin artikull siç paraqiten aktivitet të së njëjtës natyrë që zotëron. Aktivitet me të drejtë përdorimi (ROU) që plotësojnë përkufizimin e Aktiveve të së investimit janë paraqitur me Aktivitet e Investimit.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

F. Aktivet aftagjata jomateriale

Aktivitet aftagjata jomateriale të shoqërisë kanë jetë të dobishme të përcaktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, licenca dhe punime në proces.

Licensat e programeve kompjuterike kapitalizohen në bazë të kostove të nevojshme për blerjen dhe deri në vendosjen e tyre në përdorim.

- Programe kompjuterike
- Licensat

Jeta e dobishme në vite

deri në 10 vjet

deri në 10 vjet

Nëse zhvlerësohen, vlera kontabël e aktiveve jo-materiale shënohen në vlerën më të lartë të përdorimit dhe në vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Aktivitet aftagjata jo-materiale që kanë një jetë të dobishme të papërcaktuar ose aktive jo-materiale jo të gatshme për përdorim nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen çdo vit për zhvlerësim. Aktivitet që i nënshtrohen zhvlerësimit dhe amortizimit rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethanat tregojnë se vlera kontabël neto mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për vlerën më të cilën shumën e mbartur e aktivitet tejkalon vlerën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e një aktiviteti minus kostot e çregjistrimit dhe vlerës në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit, aktivitet grumbullohen në nivelet më të ulëta për të cilat ka hyrje monetare kryesisht të pavarura (njësi gjeneruese të mjeteve monetare). Zhvlerësimet e mëparshme të aktiveve jo financiare (përveç emrit të mirë), nëse ka, shqyrtohen për kthim të mundshëm në çdo datë raportimi.

G. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi në qoftë se ka faktorë në treg që tregojnë se aktivitet mund të jenë zhvlerësuar. Në rast se ekziston një tregues i tillë, ose kur kërkohet testimi vjetor për një aktivitet zhvlerësuar, Shoqëria vlerëson vlerën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e aktivitet është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të aktivitet, ose njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim të aktivitet, dhe përcaktohet për një aktivitet individual, përveçse kur aktiviteti nuk gjeneron flukse monetare hyrëse të cilat janë më së shumti të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të aktiveve të Shoqërisë. Kur vlera e mbartur e një aktivitet ose e njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon vlerën e vlerës së rikuperueshme, aktivitet konsiderohet i zhvlerësuar dhe vlera e tij zvogëlohet deri në vlerën e tij të rikuperueshme. Gjatë përcaktimit të shumës në përdorim, flukset e pritshme monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur normën e zbritjes para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për këtë aktivitet. Në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot të transaksionit, merren në konsideratë transaksionet më të fundit në treg, në rast se ka të tilla. Në rast se transaksione të tilla nuk identifikohen, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi. Keto llogaritje mbështeten nga vlerësimet të shumfishta, çmimet e aksioneve të kuotuar për filialet e tregtuara në bursa, ose tregues të tjerë të vlerës së drejtë.

Shoqëria për llogaritjen e zhvlerësimit bazohet në buxhete të detajuara dhe parashikime të cilat janë përgatitur veçmas për çdo njësi të gjenerimit të mjeteve monetare të Shoqërisë, të cilat janë të alokuara aktivitet individuale. Buxhetet dhe parashikimet përgjithësisht mbulojnë një periudhë pesë vjeçare. Për periudhën më të gjatë llogaritet një normë aftagjatë rritjeje dhe aplikohet në skontimin e flukseve monetare të ardhshme pas vitit të pestë. Humbjet nga zhvlerësimi për proceset e vazhdueshme, duke përfshirë zhvlerësimet në inventar, njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, në ato kategori shpenzimesh që janë në përputhje me funksionin e aktivitet zhvlerësuar, përveç pronave paraparakishtë të rivlerësuar kur rivlerësimi është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Në këtë rast zhvlerësimi njihet gjithashtu në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në vlerën e ndonjë rivlerësimi të mëparshëm.

Për aktivitet me përjashtim të emrit të mirë, bëhet një vlerësim në çdo datë raportimi në rast se ka ndonjë tregues që tregon se humbjet nga zhvlerësimet nuk ekzistojnë ose janë ulur. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, Shoqëria vlerëson vlerën e rikuperueshme të aktivitet ose të njësisë së gjenerimit të mjeteve monetare. Humbjet e mëparshme të zhvlerësimit mund të rimerren vetëm në qoftë se ka pasur një ndryshim në supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme të aktivitet që nga njohja e fundit e humbjes nga zhvlerësimi. Kjo rimarrje është e kufizuar në mënyrë që shumën e mbartur e aktivitet të mos kalojë vlerën e rikuperueshme dhe gjithashtu mos të tejkalojë vlerën e mbartur e cila do të ishte e përcaktuar, si amortizim neto, në rast se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk do të ishte njohur për aktivitet në vitet e mëparshme. Kjo rimarrje njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse përveçse kur aktiviteti mbahet me vlerën e rivlerësuar të aktivitet, rast në të cilin rikthimi trajtohet si një rritje nga rivlerësimi.

ANTEA CEMENT SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

H. Instrumentat Financiare

Termet kryesorë të matjes. Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg aktiv është ai në të cilin transaksionet për aktivin ose detyrimin kryhen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimin në mënyrë të vazhdueshme.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose detyrimin individual dhe numrin e instrumenteve të mbajtura nga njëسيا ekonomike. Ky është rasti edhe nëse vëllimi normal ditor i tregimit të një tregu nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e mbajtur dhe vendosja e porosive për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknikat e vlerësimit, të tilla si modelet e skontuara të flukseve monetare ose modelet e bazuara në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetëshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën ose duke marrë parasysh të dhënat financiare të të investuarve përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i çmimit të tregut të jashtëm nuk disponohet. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: (i) niveli 1 është matja me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika vlerësimi me të gjitha inputet materiale e vëzhgueshme për aktivin ose detyrimin, qoftë drejtpërdrejt (d.m.th., si çmime) ose indirekt (d.m.th., që rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e tregut të vëzhgueshëm (d.m.th., matja kërkon inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme). Transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë supozohet se kanë ndodhur në fund të periudhës raportuese. Referojuni **Shënimit 35**.

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose nxjerrjes jashtë përdorimit të një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifën dhe komisionet e paguara për agjentët (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarët, ndërmjetësit dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe bursat e letrave me vlerë, dhe taksat dhe detyrimet e transferave. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxhit ose zbritjet, kostot e financimit ose kostot e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kostoja e amortizuar ("AC") është shuma në të cilën instrumenti financiar u njoh në njohjen fillestare minus çdo ripagesë të principalit, plus interesin e përlogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo provizion për humbjet e pritshme të kredisë ("ECL"). Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo premio ose zbritjeje në vlerën e maturimit duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e përlogaritura nga interesi dhe shpenzimet e përlogaritura nga interesi, duke përfshirë kuponin e përlogaritur dhe skontimin ose primin e amortizuar (përfshirë tarifën e shtyra në origjinë, nëse ka, nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave të lidhur në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, për të arritur një normë periodike konstante interesi (normë efektive të interesit) mbi vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht pagesat ose arkëtimet e parashikuara në para (duke përfshirë humbjet e ardhshme të kredisë) gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël bruto të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit skanton flukset monetare të instrumenteve të interesit të ndryshueshëm deri në datën e ardhshme të riqmimit të interesit, me përjashtim të primit ose skontimit që pasqyron diferencën e kredisë mbi normën e ndryshueshme të specifikuar në instrument, ose variabla të tjerë që nuk rivendosen në normat e tregut. Prime ose zbritje të tilla amortizohen gjatë gjithë jetës së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha tarifën e paguara ose të marra ndërmjet palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Për aktivet që janë blerë ose kreditë e zhvlerësuar ("POCI") në njohjen fillestare, norma efektive e interesit rregullohet për rrezikun e kredisë, d.m.th., ajo llogaritet bazuar në flukset e pritura të parasë në njohjen fillestare në vend të pagesave kontraktuale.

Njohja fillestare dhe matja e mëpasshme. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("FVTPL") fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar me kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të dëshmohet nga transaksionet e tjera të tregut për të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, të dhënat e të cilave përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme. Pas njohjes fillestare, një zbritje e humbjes së pritshme të kredisë ("ECL") njihet për aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar ("AC") dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("FVOCI") që rezultojnë në një humbje të menjëhershme të kontabël. Shoqëria nuk ka asete financiare FVTPL ose FVOCI në datën e raportimit.

ANTEA CEMENT SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

H. Instrumentat Financiare (Vazhdim)

Aktivet financiare - Klasifikimi dhe matja e mëpasshme - kategoritë e matjes. Shoqëria klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: Asete me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; Asete me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; Asete të matura me koston e amortizuar. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varen nga: (i) modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve përkatëse dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktivet financiare - Klasifikimi dhe matja pasuese - modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Shoqëria menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm të mbledhë flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajnë për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("mbajnë për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe shesin") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit, atëherë klasifikohen si "të tjerë" dhe maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Modeli aktual i Shoqërisë është "mbaj për të mbledhur flukse monetare".

Aktivet financiare - Klasifikimi dhe matja e mëpasshme - karakteristikat e flukseve monetare. Kur modeli i biznesit do të mbajë pasuri për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Aktivet financiare me derivatët e përfshirë konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktojnë nëse flukset e tyre të parasë janë në përputhje me tiparin e ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën kohore të parasë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas.

Aktivet financiare të Shoqërisë përfshijnë mjete monetare dhe depozita afatshkurtra, të arkëtueshme tregtare dhe të tjera.

Aktivet financiare – riklasifikimi. Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Shoqëria nuk ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe krahasuese dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

Aktivet financiare - Zhvlerësimi i aktiveve financiare - zbritja për humbjen e kredisë për ECL (Humbja e pritshme e kredisë)

Shoqëria vlerëson ECL për instrumentet e borxhit të matura në AC. Shoqëria mat ECL dhe njeh humbjet neto të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe të kontratës në çdo datë raportimi. Matja e ECL pasqyron: (i) një sasi të paanshme dhe të ponderuar të probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, (ii) vlerën kohore të parasë dhe (iii) të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa koston dhe përpjekjet e panevojshme në fund të secilës periudhë raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme.

Zbritja për humbjen e kredisë njihet duke përdorur një qasje të thjeshtuar në ECL të jetëgjatësisë së kredisë. ECL njihet nëpërmjet një llogarie zbritjeje për të shënuar vlerën kontabël neto të arkëtueshmeve në vlerën aktuale të flukseve të pritshme të mjeteve monetare të skontuara me normat e interesit.

Aktivet financiare – Fshirja. Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka bërë të gjitha përpjekjet praktike për arkëtimin e tyre dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka shpresa të arsyeshme për arkëtim. Fshirja përfaqëson një ngjarje të cregjistrimit. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së mbledhjes me forcë kur Shoqëria kërkon të rimarrë vlerat të cilat sipas kontratës janë të kërkueshme, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për arkëtim.

Aktivet financiare – Çregjistrimi. Një aktiv financiar (ose, kur aplikohet, një pjesë e një aktivi financiar ose një pjesë të një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur (a) Të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi kanë skaduar ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të marrë flukse të mjeteve monetare nga aktivi ose ka marrë detyrimin për të paguar flukset monetare të marra në tërësi pa vonesë materiale për një palë të tretë sipas një marrëveshjeje të "kalimit" dhe (i) Shoqëria ka transferuar në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, ose (ii) Shoqëria nuk ka transferuar as nuk ka ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Kontrolli ruhet nëse pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për t'ia shitur aktivin në tërësi një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë në lidhje me shitjen.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

H. Instrumentat Financiare (Vazhdim)

Detyrimet Financiare - Klasifikimi dhe matja e mëpasshme - kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas në AC, përveçse (i) detyrimeve financiare në FVTPL: ky klasifikim zbatohet për derivatët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet afatshkurtra në letra me vlerë), konsiderata kontingjente e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë. Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë borxhet e tregtisë dhe të tjera, huatë dhe huamarrjet.

Detyrimet Financiare - Çregjistrimi. Një detyrim financiar çregjistrohet nga pasqyra e pozicionit financiar kur detyrimi është përmbushur, anuluar ose i ka kaluar afati.

Kur një detyrim financiar zëvendësohet nga një detyrim tjetër nga po i njëjti huadhënës me terma të ndryshuara, ose termat e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë të konsiderueshme, ky ndryshim apo modifikim, pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar me çregjistrimin e detyrimit fillestar dhe njohjen e detyrimit të ri, dhe diferenca në vlerën respektive kontabël njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Kushtet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera aktuale e flukseve të mjeteve monetare sipas kushteve të reja, duke përfshirë çdo pagesë të paguar neto nga çdo tarifë e marrë dhe zbritur duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e flukset monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i afateve llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar njihet si pjesë e fitimit ose humbjes në shlyerje. Nëse shkëmbimi ose modifikimi nuk llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar regullon vlerën kontabël të pasivit dhe amortizohet gjatë afatit të mbetur të pasivit të modifikuar.

Ndryshimet e detyrimeve që nuk rezultojnë në shlyerje llogariten si një ndryshim në vlerësim duke përdorur një metodë kumulative kapëse, për çfarëdo fitimi ose humbje të njohur në fitim ose humbje, përveç nëse përmbajtja ekonomike e diferencës në vlerat e mbartura i atribuohet një transaksioni kapital me pronarët.

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe vlera neto raportohet në pasqyrat financiare, vetëm në qoftë se ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar vlerat e njohura të tyre dhe ekziston qëllimi për ti shlyer në vlerën neto, ose për të njohur aktivin dhe shlyer detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë kompensimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat: (i) rrjedhën normale të biznesit, si dhe (ii) në rast falimentimi.

I. Mjetet monetare dhe depozitat afatshkurtra

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë mjetet monetare në arkë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime likuide afatshkurtra me afat maturimi tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përbëhen nga mjete monetare në arkë dhe depozita afatshkurtra të përcaktuara më lart, pasi i zbritet teprica e overdraft-ve bankare.

J. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arketueshme

Llogari të arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivate me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Pas matjes fillestare, aktivet e tilla financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("EIR"), dhe duke zbritur zhvlerësimin. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose premium për blerjen dhe tarifën ose kostot që janë pjesë përbërëse e EIR-së. Amortizimi i EIR është përfshirë në të ardhurat financiare në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet që rrjedhin nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave në shpenzimet financiare.

K. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës dhe regjistrohen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas kostoja amortizohet duke përdorur metodën e interesit efektiv. Llogaritë e pagueshme klasifikohen si detyrime afatshkurtra nëse pagesa kryhet brenda një viti ose më pak (ose në ciklin normal operativ të biznesit, nëse është më i gjatë se një vit). Në rast se jo, ato njihen si detyrime afatgjata.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

L. Huamarrjet

Pas njohjes fillestare, interesat e huave dhe huamarrjeve maten në vazhdimësi me koston e amortizuar, duke përdorur normën efektive të interesit. Fitimi dhe humbja njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur detyrimet çregjistrohen gjithashtu me metodën e amortizimit duke përdorur normën efektive të interesit (NEI).

Kostoja e amortizimit llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje apo prim si dhe komisione apo kosto të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit (NEI). Norma efektive e interesit është e përfshirë në kostot financiare të pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Kostot e huamarrjes. Kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi, që nuk mbahen me vlerën e drejtë dhe që kërkojnë një periudhë të gjatë kohore për të përgatitur aktivin për përdorim apo për shitje, kapitalizohen si pjesë e kostove të aktivit përkatës nëse data e fillimit të kapitalizimit është më ose pas 1 janarit 2009.

Data e fillimit të kapitalizimit është kur (a) Shoqëria kryen shpenzime për aktivin e kualifikuar; (b) mbarat kostot e huamarrjes; dhe (c) ndërmerr aktivitete që janë të nevojshme për të përgatitur aktivin për përdorimin ose shitjen e synuar. Kapitalizimi i kostove të huamarrjes vazhdon deri në datën kur aktivet janë në thelb gati për përdorim ose shitje. Shoqëria kapitalizon kostot e huamarrjes që mund të ishin shmangur nëse nuk do të kishte bërë shpenzime kapitale për aktivet e kualifikuara. Kostot e huamarrjes të kapitalizuara llogariten me koston mesatare të financimit të Shoqërisë (kostoja mesatare e ponderuar e interesit zbatohet për shpenzimet për aktivet kualifikuese), përveç rasteve kur fondet janë huazuar posaçërisht për qëllimin e blerjes së një aktivi. Kur kjo ndodh, kostot aktuale të huamarrjes për huamarrjen specifike minus çdo të ardhur nga investimi i këtyre huamarrjeve kapitalizohen.

M. Detyrimet e qirasë.

Detyrimet që rrjedhin nga një qira maten fillimisht mbi bazën e vlerës aktuale. Detyrimet e qirasë përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave të qirasë në vijim:

- Pagesat fikse (duke përfshirë pagesat fikse në substancë), minus çdo stimul qiraje të arkëtueshme,
- Vlerat që priten të paguhen nga Shoqëria nën garancitë e vlerës së mbetur,
- çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Shoqëria është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do ta ushtrojë atë opsion, dhe
- pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron shoqërinë që e ushtron këtë opsion

Opsionet e zgjatjes dhe përfundimit përfshihen në disa prej qirave të Shoqërisë. Këto terma përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në drejtim të menaxhimit të asetëve të përdorura në operacionet e Shoqërisë. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit të mbajtura janë të ushtrueshme vetëm nga Shoqëria dhe jo nga qiradhënësi përkatës. Opsionet e zgjatjes (ose periudha pas opsioneve të përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të zgjatet (ose nuk do të përfundojë). Pagesat e qirasë që do të kryhen sipas disa opsioneve të arsyeshme të zgjatjes përfshihen gjithashtu në matjen e detyrimit.

Pagesat e qirasë skontohehen duke përdorur normën e interesit të përmëndur në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, gjë që është përgjithësisht rasti për qiratë e Shoqërisë, përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërisë, që është norma që Shoqëria duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme me aktivin me të drejtën e përdorimit në një mjedis të ngjashëm ekonomik me kushte, kolaterale dhe kushte të ngjashme.

Për të përcaktuar normën në rritje të huamarrjes, Shoqëria:

- përdor normën rritëse të huamarrjes siç merret nga grupi

Pagesat e qirasë shpërndahen ndërmjet kostos së principalit dhe atij financiar. Kostot financiare ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë periodike konstante interesi për tepicën e mbetur të detyrimit për çdo periudhë.

Pagesat e lidhura me qiratë afatshkurtra të pajisjeve dhe automjeteve dhe të gjitha qiratë e aktiveve me vlerë të ulët njihen në mënyrë lineare si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qiratë me një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak. Mjetet me vlerë të ulët përfshijnë sende të vogla me vlerë 500 mijë lekë ose më pak. Për të optimizuar kostot e qirasë gjatë periudhës së kontratës, Shoqëria ndonjëherë ofron garanci për vlerën e mbetur në lidhje me qiratë e pajisjeve. Shoqëria fillimisht vlerëson dhe njeh vlerat që priten të paguhen nën garancitë e vlerës së mbetur si pjesë e detyrimit të qirasë.

Në mënyrë tipike, vlera e mbetur e pritur në fillimin e qirasë është e barabartë ose më e lartë se shuma e garantuar, dhe kështu Shoqëria nuk pret të paguajë asgjë sipas garancive. Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat e mbetura të pritshme rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, për të pasqyruar vlerat e mbetura aktuale të arritura mbi aktivet e krahasueshme dhe pritishtëritë për çmimet e ardhshme.

ANTEA CEMENT SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

M. Detyrimet e qirasë (Vazhdim)

Qira operative. Kur Shoqëria është qiradhënëse në një qira, e cila nuk transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë tek qiramarrësi (d.m.th., qiraja operative), pagesat e qirasë nga qiratë operative njihen si të ardhura të tjera mbi bazën lineare. Modifikimi i një qiraje llogaritet nga qiradhënësi si një qira e re që nga data efektive e modifikimit, duke marrë parasysh çdo pagesë të qirasë së parapaguar ose të përlogaritur në lidhje me qiranë fillestare si pjesë e pagesave të qirasë për qiranë e re.

N. Tatimet

Tatimet mbi fitimin janë raportuar në pasqyrat financiare për qëllime të posaçme në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese. Taksa e tatimit mbi të ardhurat prej 15% (2020: 15%) përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, vetëm nëse kjo është njohur në kapitalin neto ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimin nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta janë autorizuar para se të dorëzohen deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave përlogaritet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit për humbjet tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohshme që linden midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon as fitimin kontabël as atë të tatueshëm. Detyrimet tatimore të shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të emrit të mirë, dhe më pas për emrin e mirë që nuk është i zbritshëm për qëllime tatimore. Balancat tatimore të shtyra maten me normat e tatimit të miratuara ose të vendosura substancialisht në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore e mbartur.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore të mbartura regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që diferenca e përkohshme të kthehet në të ardhmen dhe ekziston fitim i mjaftueshëm i ardhshëm, i tatueshëm në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

Shoqëria kontrollon anulimin e diferencave të përkohshme në lidhje me taksat e pagueshme për dividendët nga filialet ose për fitimet që kanë në dispozicion. Shoqëria nuk njeht detyrime tatimore të shtyra për diferencat e tilla të përkohshme përveç në atë masë që menaxhimi pret që diferencat e përkohshme të kthehen në të ardhmen e parashikueshme.

Pozicionet e pasigurta tatimore. Pozitat e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga menaxhimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojnë në vendosjen e taksave shtesë nëse keto pozicione do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratohen në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, si dhe vendime të njohura nga gjykatat mbi çështje të tilla. Detyrimet për penalitetet, interesat dhe detyrimet tatimore të tjera nga të ardhurat, njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda tatimit mbi të ardhurat.

Taksa mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në momentin më të hershëm se, (a) grumbullimin e kërkesave të arkëtueshme nga klientët ose (b) lëvrimin e mallrave ose shërbimeve tek klientët. TVSH-ja në blerje në përgjithësi mund të rikuperohet kundrejt TVSH-së së shitjeve pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe shpaloset veçmas si një aktiv dhe pasiv. Aty ku është bërë një provizion për ECL të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për vlerën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në. Bazuar në legjislacionin tatimor, pas përmbushjes së kritereve të nevojshme TVSH-ja mund të rikuperohet/shlyhet, si rrjedhojë këto shuma janë marrë parasysh në përlogaritjen e zhvlerësimeve për të arketueshmet nga klientët.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

O. Inventarët

Inventarët regjistrohen me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e produkteve të gatshme dhe e produkteve në proces përbëhet nga lënda parë, puna direkte, kosto të tjera direkte dhe shpenzime të përgjithshme të prodhimit (bazuar në kapacitetin normal operativ), por përjashton koston e huamarrjes. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në kushtet normale të veprimtarisë të biznesit, minus koston e vlerësuar të përfundimit të procesit të prodhimit dhe koston e vlerësuar të nevojshme për të kryer shitjen.

Shpenzimet e kryera për të sjellë produktet në vendndodhjen aktuale dhe në kushtet e nevojshme llogariten si më poshtë:

Lënda e parë:

> Me koston e blerjes sipas metodës së koston mesatare

Produktet e gatshme dhe prodhimi në proces:

> Me koston e punës dhe materialeve direkte dhe një pjesë të shpenzimeve të tjera të përgjithshme bazuar në kapacitetin normal prodhues, por duke përjashtuar koston e huamarrjes.

P. Kapitali

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, mbi të ardhurat. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si premium i aksioneve në kapital.

Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, janë të shpalosura në shënimet e ngjarjeve të mëvonshme. Pasqyrat financiare ligjore të Shoqërisë janë baza për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjeve të tjera.

Q. Perfitimet nga shperblimet e bazuara ne aksione

Përfitimet nga shperblimet a bazuara në aksione u sigurohen anëtarëve të menaxhmentit të lartë përmes skemave të aksioneve të Grupit që mbulojnë disa filiale. Pjesëmarrësit e planit (d.m.th., kundërpala) u informuan për programin më 14.5.2020 (d.m.th., subjekti dhe pala kanë një kuptim të përbashkët të termave dhe kushteve të marrëveshjes), duke qenë data e dhënies.

Aktualisht, Grupi ka skemat e mëposhtme: 1) planet e opsioneve të aksioneve (2014 dhe 2017) dhe 2) planet afatgjatë të stimuljeve i prezantuar në vitin 2020, i cili ka të bëjë me ndarjen e aksioneve, **shënimi shpjegues 27**.

Një transaksion pagese i bazuar në aksione të Grupit klasifikohet nga perspektiva e secilës shoqëri raportuese, sesa duke bërë një përcaktim të vetëm të klasifikimit që është i zbatueshëm për të gjitha shoqëritë e grupit. Antea Cement sha merr pjesë në planin stimulues afatgjatë të vitit 2020 & 2021, i cili klasifikohet si i shlyer në para në pasqyrat financiare të Grupit, por klasifikohet si i shlyer në kapital në pasqyrat financiare të Antea Cement Sha, pasi Antea Cement Sha nuk ka asnjë detyrim për të shlyer këtë kompensim. Si pasojë, ajo njih vlerën e drejtë të shpërblimeve si shpenzime të përfitimeve të punonjësve në pasqyrën e fitim humbjes, me një rritje përkatëse në zërin Opsionet e Aksioneve në kategorinë e Kapitalit dhe Rezervave.

Shuma totale që do të shpenzohet përcaktohet duke iu referuar vlerës së drejtë të përfitimeve të dhëna, e cila bazohet në çmimin e aksionit të mëmës në datën e dhënies. Shpenzimi total njihet gjatë periudhës së përfitimit, e cila është periudha gjatë së cilës plotësohen kushtet e specifikuar të shërbimit. Në fund të secilës periudhë, Antea Cement sha rishikon vlerësimet e saj për numrin e kompensimeve që pritet të japen në bazë të kushteve të specifikuar të përfitimit dhe shkallës së mos-përfitimit. Shoqëria njih efektin e rishikimit të vlerësimeve fillestare, nëse ka, në paqyrën e fitim humbjes, si dhe me kundër-vlerën përkatëse në zërin Opsionet e Aksioneve në kategorinë e Kapitalit dhe Rezervave.

R. Dividendët

Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën janë deklaruar dhe miratuar.

ANTEA CEMENT SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

S. Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbje operacionale të ardhshme.

Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të nevojitet në shlyerje përcaktohet duke marrë parasysh klasën e detyrimeve në tërësi. Një provizion njihet edhe nëse gjasat e një fluksi dalës në lidhje me çdo zë të përfshirë në të njëjtën klasë të detyrimeve mund të jenë të vogla.

Rezervat maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që duhen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provizion për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim i interesit.

T. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e faturuar për shitjen e mallrave dhe shërbimeve pa tatimin e vlerës së shtuar, zbritjet dhe eliminimin e shitjeve brenda shoqërisë. Çmimi i transaksionit është ai që Shoqëria pret të ketë të drejtë të arkëtoje në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar vlerat e mbledhura në emër të palëve të treta.

Shitja e Mallrave. Shitjet njihen kur kontrolli mbi mallin është transferuar, në momentin kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, liri ka liri të plotë mbi mallrat dhe nuk ka detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë dërguar në vendndodhjen specifike, rreziqet e dëmtimit dhe humbjes janë transferuar tek klienti dhe klienti ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën, kriteret e pranimit janë plotësuar ose Shoqëria ka bindjen objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.

Të ardhurat nga shitjet me ulje njihen në bazë të çmimit të specifikuar në kontratë, duke zbritur uljet e parashikuara lidhur me volumet. Eksperienca e akumuluar përdoret për të vlerësuar dhe siguruar uljet, duke përdorur metodën e vlerës së pritshme dhe të ardhurat njihen vetëm në masën për të cilën ka siguri se sdo të ndodhin ndryshime të rëndësishme. Një detyrim rimbursimi (i përfshirë në detyrimet tregtare dhe të tjera) njihet për uljet e pritshme të vëllimit të pagueshëm për klientët në lidhje me shitjet e bëra deri në fund të periudhës raportuese.

Asnjë element i financimit nuk konsiderohet i pranishëm pasi shitjet bëhen me një afat shlyerje prej 30 deri në 120 ditë, që është në përputhje me praktikën e tregut.

Një arkëtim njihet kur mallrat dorëzohen pasi kjo është pika në kohë që shqyrtimi është i pakushtëzuar, sepse kërkohet vetëm kalimi i kohës përpara se të bëhet pagesa.

Nëse Shoqëria ofron shërbime shtesë ndaj klientit pasi kontrolli mbi mallrat ka kaluar, të ardhurat nga shërbimet e tilla konsiderohen si një detyrim i veçantë i performancës dhe njihen gjatë kohës së dhënies së shërbimit.

Shitja e shërbimeve. Shoqëria ofron shërbime me kontrata fikse. Të ardhurat nga shërbimet njihen në periudhën kontabël në të cilën ofrohen shërbimet. Për kontratat me çmim fikse, të ardhurat njihen në bazë të shërbimit aktual të ofruar deri në fund të periudhës raportuese si një pjesë e totalit të shërbimeve që duhet të ofrohen, sepse klienti merr dhe përdor përfitimet njëkohësisht.

Kur kontratat përfshijnë detyrime të shumfishta të performancës, çmimi i transaksionit ndahet për secilin detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet shitëse të pavarura.

Në rastin e kontratave me çmim fikse, klienti paguan vlerën fikse bazuar në një skemë pagesash. Nëse shërbimet e kryera nga Shoqëria tejkalojnë pagesën, njihet një aktiv kontrate. Nëse pagesat tejkalojnë shërbimet e kryera, njihet një detyrim kontrate.

Nëse kontrata përfshin një tarifë orare, të ardhurat njihen në vlerën në të cilën Shoqëria ka të drejtë të faturojë. Konsumatorët faturohen për shpenzimet e transportit si një detyrim i veçantë i performancës.

Të ardhura nga interesi. Të ardhurat nga interesi njihen në përpjestim me kohën duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat në lidhje me depozitat me afat njihen gjatë kohës që interesi akumulohet. Të ardhurat nga interesi përfshihen në të ardhurat e financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

U. Përfitimet e punonjësve

Pagat, kontributet në fondet e pensioneve shtetërore dhe ato të sigurimeve shoqërore, lejet vjetore dhe pushimet mjekësore, shpërblimet dhe përfitimet jomonetare (siç janë shërbimet shëndetësore) grumbullohen në vitin në të cilin shërbimet e lidhura jepen nga punonjësit e Shoqërisë. Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të bërë pagesa të pensioneve ose përfitimeve të ngjashme përtej skemës ligjore të kontributeve të përcaktuara.

ANTEA CEMENT SH.A.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

V. Periudhat krahasuese

Shifrat për periudhat krahasuese janë riklasifikuar atëherë kur është gjykuar si e përshtatshme, për të qënë në përputhje me ndryshimet në paraqitje e periudhës aktuale. Këto riklasifikime, gjithsesi, nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme në përmbajtjen dhe formën e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare.

4. GJYKIMET DHE VLERSIMET E RËNDËSISHME KONTABËL, NE APLIKIMIN E POLITIKAVE KONTABËL

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në vlerat e njohura në pasqyrat financiare dhe në vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Drejtimi gjithashtu bën disa gjykime, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

I. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Drejtimi i Shoqërisë përlogarit një fond zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta për të përlogaritur humbjet e mundshme të cilat mund të rezultojnë si pasojë e paaftësisë paguese të klientëve për të paguar vlerat e caktuara.

Matja e ECL është një vlerësim i rëndësishëm që përfshin metodologjinë e përcaktimit, modelet dhe inputet e të dhënave. Shoqëria vlerëson në mënyrë individuale të gjitha rastet gjyqësore dhe llogaritë e arkëtueshme për më shumë se 365 ditë. Humbja e pritshme e kredisë është produkt i ekspozimit të parazgjedhur, humbjes së parazgjedhur dhe probabilitetit të mospagimit. Kosto mesatare e kapitalit prej 9.5% përdoret për përlogaritjen e vlerës së zbritur.

Të gjitha llogaritë e tjera tregtare vlerësohen kolektivisht duke përdorur një qasje të thjeshtuar në ECL gjatë jetëgjatësisë së tyre. Raportet e humbjeve sipas kategorive llogariten bazuar në matricën e provizioneve që e konsideron ekspozimin me vonesë, normat e vonesës historike, dërgesën e klientit dhe ndryshimet në kushtet e pagesës së klientit.

II. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale

Mbajtja e kontabilitetit për aktivet afatgjata të trupëzuara dhe aktiveve afatgjata të patrupëzuara përfshin përdorimin e vlerësimeve në përcaktimin e jetëgjatësisë së dobishme të aktiveve dhe vlerën e tyre të mbetur. Përcaktimi i jetëgjatësisë së dobishme të aktivitetit është bazuar në gjykimin e drejtimit. Informacione të mëtejshme jepen në shënime 2(g),(h),16 dhe 17.

III. Taksat

Në lidhje me interpretimin e rregulloreve komplekse të taksave, ndryshimeve në ligjet tatimore, si dhe shumës dhe kohës së të ardhurave të ardhshme të taksueshme ekzistojnë pasiguri të ndryshme. Për shkak të gamës së gjërë të marrëdhënieve të biznesit ndërkombëtar si dhe natyrës afatgjatë dhe kompleksitetit të marrëveshjeve ekzistuese kontraktuale, diferencat e lindura midis rezultateve aktuale dhe supozimeve të bëra, ose ndryshimeve të ardhshme të supozimeve mund të çojnë në nevojën e korigjimit të të ardhurave të taksueshme dhe shpenzimeve tashmë të regjistruara. Shoqëria krijon provizione bazuar në vlerësime të arsyeshme, që lidhen me pasojat e mundshme nga kontrollet e kryera nga autoritetet tatimore të vendit në të cilin Shoqëria operon. Vlera e provizioneve bazohet në disa faktorë, si psh: përvoja e mëparshme nga kontrollet tatimore dhe interpretime të ndryshme të rregulloreve tatimore nga njësi e tatueshme ose autoriteti përgjegjës tatimor.

Diferencat e interpretimeve mund të shkaktohen nga çështje të ndryshme që varen nga kushtet ekzistuese në mjedisin ku Shoqëria operon. Kur Shoqëria e vlerëson të ulët probabilitetin që një çështje gjyqësore e lidhur me taksat të rezultojë në fluks dalës mjetesh monetare, ajo nuk njeh detyrime të kushtëzuara.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

4. GJYKIMET DHE VLERESIMET E RËNDËSISHME KONTABËL, NE APLIKIMIN E POLITIKAVE KONTABEL (VAZHDIM)

IV. Kostot e restaurimit të mjedisit – Provizionet për pyllëzimin

Shoqërisë i kërkohet që të restaurojë duke ripyllëzuar guroret ose vendet e punimeve në baza vjetore bazuar me një program të caktuar. Keto restaurime janë kryer çdo vit dhe kostot përkatëse janë njohur në rezultatet financiare të Shoqërisë.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhme që ndikohet.

Në veçanti, informacioni rreth fushave të rëndësishme të pasigurisë në vlerësimet dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë më shumë efekt në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënime të mëposhtme:

Shënimi 16 – Tatimi mbi të ardhurat
Shënimi 23 – Llogaritë e arkëtueshme
Shënimi 31 – Provizionet
Shënimi 36 – Angazhimet dhe detyrimet/aktivet e kushtëzuara

5. ADAPTIMI I INTERPRETIMEVE DHE STANDARTEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA

Politikat e kontabilitetit të adoptuara gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare janë në përputhje me ato të ndjekura në përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, përveç adoptimit të standardeve dhe interpretimeve të reja efektive që nga 1 janari 2021

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive për Shoqërinë nga 1 janari 2021 por nuk patën ndonjë ndikim material në Shoqëri.

Konçesionet e qirasë të lidhura me Covid-19 – Ndryshime në SNRF 16 (publikuar më 31 mars 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 prill 2021). Në maj 2020 u lëshua një ndryshim në SNRF 16 që ofronte një mundësi praktike opsionale për qiramarrësit nga vlerësimi nëse një koncesion i qirasë në lidhje me COVID-19, që rezultoi në një reduktim të pagesave të qirasë që paguhet më 30 qershor 2021 ose përpara, ishte një modifikim i qirasë. Një ndryshim i lëshuar më 31 mars 2021 zgjati datën e përdorimit praktik nga 30 qershor 2021 në 30 qershor 2022.

Reforma e normës bazë të interesit (IBOR) – ndryshimet e fazës 2 të SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (publikuar më 27 gusht 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2021). Ndryshimet e Fazës 2 trajtojnë çështjet që lindin nga zbatimi i reformave, duke përfshirë zëvendësimin e një standardi me një alternativë. Ndryshimet mbulojnë fushat e mëposhtme:

- Kontabilizimi i ndryshimeve në bazën për përcaktimin e flukseve monetare kontraktuale si rezultat i reformës IBOR: Për instrumentet për të cilat zbatohet matja e kostos së amortizuar, ndryshimet kërkojnë që njësitë ekonomike, si një mundësi praktike, të llogarisin për një ndryshim në bazën për përcaktimin e flukset monetare kontraktuale si rezultat i reformës IBOR duke përditësuar normën efektive të interesit duke përdorur udhëzimin në paragrafin B5.4.5 të SNRF 9. Si rezultat, nuk njihet asnjë fitim ose humbje e menjëhershme. Kjo dobi praktike zbatohet vetëm për një ndryshim të tillë dhe vetëm në masën që është e nevojshme si pasojë e drejtpërdrejtë e reformës IBOR, dhe baza e re është ekonomikisht ekuivalente me bazën e mëparshme. Siguruesit që aplikojnë përjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 u kërkohet gjithashtu të zbatojnë të njëjtën lehtësi praktike. SNRF 16 u ndryshua gjithashtu për t'u kërkuar qiramarrësve të përdorin një mjet të ngjashëm praktik kur kontabilizohen modifikimet e qirasë që ndryshojnë bazën për përcaktimin e pagesave të qirasë në të ardhmen si rezultat i reformës IBOR.
Data e përfundimit për lehtësimin e Fazës 1 për komponentët e rrezikut jo të specifikuar kontraktualisht në marrëdhëniet mbrojtëse: Ndryshimet e Fazës 1 kërkojnë që një njësi ekonomike të pushojë së zbatuari lehtësimet e Fazës 1 për një komponent rreziku jo të specifikuar kontraktualisht më herët kur bëhen ndryshime në komponentin e rrezikut jokontraktualisht të specifikuar, ose kur marrëdhënia mbrojtëse ndërpritet. Në ndryshimet e Fazës 1 për komponentët e rrezikut nuk jepet një datë përfundimtare.
- Përjashtime të përkohshme shtesë nga zbatimi i kërkesave specifike të kontabilitetit mbrojtës: Ndryshimet e Fazës 2 ofrojnë disa lehtësime të përkohshme shtesë nga zbatimi i kërkesave specifike të kontabilitetit mbrojtës të SNK 39 dhe SNRF 9 për marrëdhëniet mbrojtëse që preken drejtpërdrejt nga reforma IBOR.
- Dhënia e informacionit shpjegues shtesë të SNRF 7 në lidhje me reformën e IBOR: Ndryshimet kërkojnë dhënie të informacionit shpjegues për: (i) mënyrën se si njësi ekonomike po menaxhon kalimin në normat e standardeve alternative, progresin dhe rreziqet që rrjedhin nga tranzicioni; (ii) informacion sasior në lidhje me derivatët dhe jo-derivatët që ende nuk kanë kaluar në tranzicion, të ndara sipas standardit të rëndësishëm të normës së interesit; dhe (iii) një përshkrim të çdo ndryshimi në strategjinë e menaxhimit të rrezikut si rezultat i reformës IBOR.

5. ADAPTIMI I INTERPRETIMEVE DHE STANDARTEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

- Përjashtime të përkohshme shtesë nga zbatimi i kërkesave specifike të kontabilitetit mbrojtës: Ndryshimet e Fazës 2 ofrojnë disa lehtësime të përkohshme shtesë nga zbatimi i kërkesave specifike të kontabilitetit mbrojtës të SNK 39 dhe SNRF 9 për marrëdhëniet mbrojtëse që ndikohen drejtpërdrejt nga reforma e IBOR.
- Dhënia e informacioneve shpjeguese shtesë të SNRF 7 në lidhje me reformën e IBOR: Ndryshimet kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese për: (i) mënyrën se si njësi ekonomike po menaxhon kalimin në normat e standardeve alternative, progresin e tij dhe rreziqet që rrjedhin nga tranzicioni; (ii) informacion sasior për derivatët dhe jo-derivatët që nuk kanë kaluar ende, të ndara sipas standartit të rëndësishëm të normës së interesit; dhe (iii) një përshkrim të çdo ndryshimi në strategjinë e menaxhimit të rrezikut si rezultat i reformës IBOR.

Shoqëria nuk preket nga ndryshimet në reformë.

6. INTERPRETIME TË REJA TË KONTABILITETIT

Disa standarde dhe interpretime të reja të publikuara janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022 ose më vonë, dhe të cilat Shoqëria nuk i ka miratuar më herët.

- Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, data e hyrjes në fuqi e modifikuar më pas në 1 janar 2023 nga Ndryshimet në SNRF 17 siç diskutohet më poshtë).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë – Ndryshime në SNK 1 (botuar më 23 janar 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë, shtyrja e datës së hyrjes në fuqi – Ndryshime në SNK 1 (publikuar më 15 korrik 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar, Kontratat me kushte rënduese – kostoja e përbushjes së një kontrate, Referenca në Kuadrin Konceptual – ndryshime me qëllim të ngushtë në SNK 16, SNK 37 dhe SNRF 3, dhe Përmirësimet Vjetore të SNRF-ve 2018-2020 – ndryshime në SNRF 1, IFRS 9, SNRF 16 dhe SNK 41 (botuar më 14 maj 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).
- Ndryshime në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 SNRF: Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Ndryshime në SNK 8: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (lëshuar më 12 shkurt 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Koncesionet e qirave të lidhura me Covid-19 – Ndryshime në SNRF 16 (publikuar më 31 mars 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 prill 2021).
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12 (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).

Shoqëria aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

7. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga shitjet e paraqitura në pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse analizohen si më poshtë, përsa i përket tregjeve vendase, të huaja si edhe llojit të produktit.

	2021	2020
Shitje çimentoje të prodhuar	8,354,850	6,915,687
Shitje klinkeri	352,688	269,845
Shitje çimentoje të importuar	83,853	65,247
Të ardhura nga transporti	497,498	364,289
Të ardhura nga shitja e materialeve	95,564	28,643
Të ardhura nga shërbimet	69,477	117,558
Zbritje çmimi	(478,485)	(275,295)
Totali	8,975,445	7,485,974

Për më tepër shitjet janë analizuar si më poshtë përsa i përket tregjeve vendase dhe të huaja si edhe llojit të produktit

	2021	2020
Shitjet		
Tregu i brendshëm	6,047,728	4,978,499
Tregu i jashtëm	2,927,717	2,507,475
Totali	8,975,445	7,485,974
Tregu i brendshëm		
Shitje çimentoje të prodhuar	5,911,517	4,608,653
Shitje klinkeri	319,159	227,135
Shitje çimentoje të importuar	46,104	20,348
Të ardhura nga transporti	107,159	249,181
Të ardhura nga shitja e materialeve	71,709	28,643
Të ardhura nga shërbimet	68,732	117,558
Zbritje çmimi	(476,652)	(273,019)
Totali	6,047,728	4,978,499
Tregu i jashtëm		
Shitje çimentoje të prodhuar	2,443,331	2,307,034
Shitje klinkeri	33,529	42,710
Shitje çimento e importuar	37,749	44,899
Të ardhura nga transporti	390,339	115,108
Të ardhura nga shitja e materialeve	24,602	-
Zbritje çimentoje të prodhuar mimi	(1,833)	(2,276)
Totali	2,927,717	2,507,475

Shoqëria gjeneron të ardhura nga transferimi i mallrave në një moment në kohë. Për shitjet e brendshme, kontrolli transferohet në momentin që mallrat janë vendosur në dispozicion (EX-works) si dhe kur merren në ngarkim nga transportuesi. Për shitjet e eksportit, kontrolli transferohet në çastin kur mallrat janë ngarkuar në anije dhe janë gati për dërgim.

Kontratat me klientët nuk përmbajnë një komponent të konsiderueshëm të financimit, pasi kushtet e pagesës janë sipas kushteve të tregut. Miratimi i SNRF 15 nuk ka ndikuar lidhur me njohjen e të ardhurave nga Shoqëria si për shitjet ashtu edhe për të ardhurat e tjera të ilustruara në shënimin vijues.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

8. KOSTO E SHITJEVE

Kosto e shitjeve në pasqyrën e fitim-humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse paraqitet e detajuar si më poshtë:

	2021	2020
Kostot e ndryshueshme	5,351,113	3,504,409
Shpenzimet e transportit dhe logjistikes	807,243	688,842
Lënda djegëse e furrës	1,608,204	1,053,222
Energji elektrike	1,588,459	639,614
Lëndët e para dhe shtesat	711,588	507,010
Tulla refraktare	62,838	63,719
Karburant	15,814	8,082
Renta minerare	58,735	50,513
Shpenzimet e paketimit	348,821	380,546
Kosto e çimentos së importuar	74,214	78,746
Kosto e materialeve të shitura	70,550	27,300
Të tjera	4,647	6,815
Kostot Fikse	1,509,618	1,543,323
Pagat dhe shpenzime të ngjashme (Shënimi 13)	274,846	259,167
Riparimi dhe mirëmbajtja- pjesë këmbimi	111,399	109,490
Shërbime nga palët e treta	231,273	215,658
Shpenzime qiramarrje	308	313
Shërbime për fabrikën	18,913	18,255
Kosto të tjera fikse	40,938	36,476
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	812,621	804,978
Amortizimi i aktiveve me të drejta përdorimi	14,746	15,118
Ndryshimi gjendjes së inventarit	4,574	83,868
Totali	6,860,731	5,047,732

Shpenzimet e transportit dhe logjistikes paraqiten të detajuara si më poshtë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021 dhe 2020:

	2021	2020
Shpenzimet e transportit për shitjet në tregun e brendshëm	205,775	249,181
Shpenzimet e transportit dhe logjistikës për shitjet në eksport	243,549	217,733
Shpenzimet e transportit qe lidhen me transportin detar	357,919	221,928
Totali	807,243	688,842

9. TË ARDHURA TË TJERA OPERACIONALE

Të ardhura të tjera në pasqyrën e fitim-humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse paraqiten të detajuar si më poshtë:

	2021	2020
Rimbursim akcize	39,823	49,361
Rimarrje e provizioneve për llogaritë e arkëtueshme	-	9,564
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	5,788	-
Terprica e inventarit	92	-
Të ardhura të tjera operative	10,662	11,045
Totali	56,365	69,970

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

10. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzime të tjera në pasqyrën e fitim-humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse paraqiten të detajuara si më poshtë:

	2021	2020
Humbje nga shitja/nxjerrja nga përdorimi i aktiveve afatgjata	5,461	3,785
Provizione të tjera	4,793	53,820
Humbje nga inventari	-	1,502
Shpenzime të tjera	5,131	13,180
Totali	15,385	72,287

2021: Të përfshira në provizione të tjera në vlerën 788 mijë Lekë janë provizione për inventare (Shënimi 22) dhe shuma prej 4,005 mijë Lekë lidhet me kosto shtesë të personelit (Shënimi 31).

2020: Të përfshira në provizione të tjera në vlerën 5,053 mijë Lek janë provizione për asete të tjera afat-shkurtra (Shënimi 24). Shuma prej 45,123 mijë Lekë lidhet me provizione për inventarë (Shënimi 22) dhe shuma prej 3,644 mijë Lekë lidhen me kosto shtesë të personelit (Shënimi 31).

11. SHPENZIME SHITJEJE DHE MARKETINGU

Shpenzimet e shitjes dhe të marketingut në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse analizohen si më poshtë:

	2021	2020
Pagat dhe shpenzime të tjera të ngjashme (Shënimi 13)	49,128	51,335
Shpenzime për shërbime	11,850	9,721
Amortizim i aktiveve me të drejta përdorimi	4,124	3,728
Shpenzime të tjera	3,930	5,010
Totali	69,032	69,794

12. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative në pasqyrën e fitim-humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse analizohen si më poshtë:

	2021	2020
Tarifat për konsulencë	196,280	219,070
Pagat dhe shpenzime të ngjashme (Shënimi 13)	96,883	91,882
Furnizime	77,225	75,798
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	71,408	72,314
Amortizimi i aktiveve me të drejta përdorimi	19,270	20,346
Siguracione dhe taksa	36,135	35,461
Mirëmbajtje dhe riparime	15,888	7,400
Shpenzime për shërbime (drita, ujë etj)	4,378	4,352
Shpenzime për udhëtime	1,388	1,174
Tarifat e auditimit	2,638	4,930
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	24,386	23,925
Shpenzime të tjera	36,953	33,951
Totali	582,832	590,603

13. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet për përfilimet e punonjësve të përfshira në kostot e shitjes, shpenzimet e shitjes dhe marketingut si dhe shpenzimeve administrative janë përmbledhur si më poshtë:

	2021	2020
Pagat bruto	330,213	313,770
Shpenzime të tjera të ngjashme	90,644	88,614
Totali	420,857	402,384
<i>E ndarë si më poshtë:</i>		
Kostot e shitjeve (Shënimi 8)	274,846	259,167
Shpenzime shitjeje dhe marketingu (Shënimi 11)	49,128	51,335
Shpenzime administrative (Shënimi 12)	96,883	91,882
Totali	420,857	402,384

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

14. SHPENZIMET FINANCIARE, NETO

Shpenzimet financiare neto, për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë paraqitur si më poshtë:

	2021	2020
Shpenzime për interesa	(414,686)	(592,393)
Të Ardhura / (Humbje) neto nga kursi i këmbimit	119,779	(137,477)
Shpenzime të tjera financiare	(8,378)	(6,920)
Shpenzime për interesa - qira	(4,532)	(4,744)
Shpenzime financiare neto	(307,817)	(741,534)

15. TE ARDHURA NGA DIVIDENDI

Në datën 27 korrik 2021 Shoqëria ka marrë të ardhurat vjetore nga dividendët nga filiali i saj ALBA CEMENTO Sh.p.k. në vlerën 12,478 mijë lekë. (Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020 9,802 mijë lekë).

16. TATIMI MBI FITIMIN

a) Elementet e shpenzimit/(përfitimit) të tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatim fitimit të regjistruar në pasqyrën e fitim humbjes janë paraqitur si më poshtë::

	2021	2020
Shpenzimi i Tatim Fitimit të periudhës	(238,472)	(219,852)
Tatim fitimi i shtyrë	36,173	25,136
	(202,299)	(194,716)

b) Rakordimi i shpenzimit të tatim fitimit dhe fitimit ose humbjes shumëzuar me normën tatimore të aplikueshme

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor të miratuar aktualisht i cili përcakton një normë të tatimit mbi të ardhurat prej 15% (2020: 15%).

Më poshtë është një rakordim i tatim fitimeve të llogaritura me normën tatimore të aplikueshme me tatimin aktual të kredituar në fitim ose humbje.

	2021	2020
Fitimi përpara Tatim Fitimit	1,208,491	1,043,796
Taksa e aplikueshme sipas normës ligjore prej 15%:	181,274	156,569
Efekti tatimor i artikujve që nuk janë të zbritshëm ose të vlerësueshëm për qëllime tatimore:		
Të ardhura të cilat përjashtohen nga tatimi	(1,872)	(2,905)
Shpenzime të pazbritshme	21,639	41,044
Aktive të tjera tatimore të shtyra të panjohura	1,258	8
Shpenzimet e tatim fitimit /(kredituar) për vitin	202,299	194,716

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

16. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)

Tatimi aktual mbi fitimin për vitin 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 llogaritet si më poshtë:

	2021	2020
Fitimi përpara Tatim Fitimit	1,208,491	1,043,796
Shtojme:		
Shpenzime të panjohura për efekt tatim fitimi	144,262	273,626
Amortizim për efekt tatimor	249,537	167,625
Zbresim:		
Të ardhura nga dividendi	(12,478)	(9,802)
Të ardhura të patatueshme	-	(9,564)
Fitimi i Tatueshem	1,589,813	1,465,680
Fitim i Tatueshem	1,589,813	1,465,680
Shpenzimi i tatim fitimit për periudhën me 15%	238,472	219,852

Sipas Legjislacionit tatimor në Shqipëri humbjet tatimore mund të mbarten për një periudhë tre vjeçare. Nuk ka humbje tatimore të mbartura më 31 dhjetor 2021 (31 dhjetor 2020; zero).

c) Tatimet e shtyra të analizuar sipas llojit të diferencës së përkohshme

Ndryshimet midis SNRF-ve dhe legjislacionit tatimor shqiptar shkaktojnë diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar si dhe bazës së tyre tatimore. Efekti i lëvizjeve në këto diferenca të përkohshme është detajuar më poshtë.

Tatimi i shtyrë është analizuar sipas llojit të diferencës së përkohshme.

	31 December 2019	Shepenzim/ (e ardhur) në pasqyrën e fitim humbjes	31 December 2020	Shepenzim/ (e ardhur) në pasqyrën e fitim humbjes	31 December 2021
Diferenca midis Amortizimit Kontabel/amortizimit për qëllime tatimore	(1,246,948)	25,144	(1,221,804)	37,421	(1,184,383)
Rënie në vlerën e llogarive të arkëtueshme dhe provizione	67,021	(533)	66,488	(1,574)	64,914
Aktive me të drejtë përdorimi	726	525	1,251	326	1,577
Tatim i shtyrë , neto aktiv/ (detyrim)	(1,179,201)	25,136	(1,154,065)	36,173	(1,117,892)
Aktivi tatimor i shtyrë i njohur	67,747	(8)	67,739	(1,248)	66,491
Detyrim tatimor i shtyrë i njohur	(1,246,948)	25,144	(1,221,804)	37,421	(1,184,383)
Tatim i shtyrë , neto aktiv/ (detyrim)	(1,179,201)	25,136	(1,154,065)	36,173	(1,117,892)

**ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE**

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

17. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Toka dhe përmirësimet	Ndërtesa	Makinieri dhe Pajisje	Automjete	Mobilije dhe Pajisje	Pajisje Elektronike	Aktive në proces	Totali
Kosto								
Më 1 janar 2020	2,897,395	1,758,981	20,030,132	23,592	32,260	215,921	334,406	25,292,687
Shtesa	-	-	-	-	379	3,664	150,500	154,543
Transferime	6,356	55,604	122,649	-	-	341	(188,545)	(3,595)
Pakësime	-	-	-	-	-	(144)	(3,785)	(3,929)
Më 31 dhjetor 2020	2,903,751	1,814,585	20,152,781	23,592	32,639	219,782	292,576	25,439,706
Shtesa	-	-	43,377	-	-	6,123	121,184	170,684
Transferime	-	-	7,316	-	-	-	(7,316)	-
Pakësime	-	-	-	-	-	(772)	(5,461)	(6,233)
Më 31 dhjetor 2021	2,903,751	1,814,585	20,203,474	23,592	32,639	225,133	400,983	25,604,157
Amortizimi i Akumuluar								
Më 1 janar 2020	603,619	395,365	6,414,048	22,212	26,166	186,791	-	7,648,201
Amortizimi për vitin	69,138	48,021	742,949	624	1,343	15,217	-	877,292
Transferime	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime i amortizimit	-	-	-	-	-	(144)	-	(144)
Më 31 dhjetor 2020	672,757	443,386	7,156,997	22,836	27,509	201,864	-	8,525,349
Amortizimi për vitin	69,655	50,802	753,312	143	1,258	8,859	-	884,029
Transferime	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime i amortizimit	-	-	-	-	-	(772)	-	(772)
Më 31 dhjetor 2021	742,412	494,188	7,910,309	22,979	28,767	209,951	-	9,408,606
Vlera Kontabël Neto								
Më 31 dhjetor 2020	2,230,994	1,371,199	12,995,784	756	5,130	17,918	292,576	16,914,357
Më 31 dhjetor 2021	2,161,339	1,320,397	12,293,165	613	3,872	15,182	400,983	16,195,551

Përfshirë në "Aktive në Proces" janë përfshirë pjesë këmbimi strategjike në vlerën 260,297 mijë Lekë (2020: 260,297 mijë Lekë).

Asnjë pronë, ndërtesë dhe pajisje nuk është vënë kolateral gjatë viteve ushtrimore të mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

18. AKTIVET AFATGJATA JO-MATERIALE

Aktivët afatgjatë jo-materialë në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Licenca	Totali
Kosto:			
Më 1 janar 2020	141,093	8,295	149,388
Shtesa	1,208	-	1,208
Transferime	3,595	-	3,595
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	145,896	8,295	154,191
Shtesa	-	-	-
Transferime	-	-	-
Pakësime	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	145,896	8,295	154,191
Amortizimi:			
Më 1 janar 2020	70,572	1,583	72,155
Amortizimi i ngarkuar për vitin	23,143	782	23,925
Më 31 dhjetor 2020	93,715	2,365	96,080
Amortizim i ngarkuar për vitin	23,603	782	24,385
Më 31 dhjetor 2021	117,318	3,147	120,465
Vlera e mbetur:			
Më 31 dhjetor 2020	52,181	5,930	58,111
Më 31 dhjetor 2021	28,578	5,147	33,725

Asnjë aktiv afatgjatë jo-material nuk është vënë si kolateral gjatë viteve ushtrimore të mbyllura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

19. AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI

Pasqyra e mëposhtme tregon vlerat në lidhje me aktivët me të drejtë përdorimi:

Aktive me të drejtë përdorimi	Ndërtesa dhe Ambjente	Automjete	Total
Vlera kontabël më 1 janar 2020	109,307	21,462	130,769
Shtesa	9,497	26,798	36,295
Pakësime	-	(545)	(545)
Vlera e amortizimit	(27,821)	(11,371)	(39,192)
Vlera kontabël më 31 janar 2020	90,983	36,344	127,327
Vlera kontabël më 1 janar 2021	90,983	36,344	127,327
Shtesa	29,989	1,796	31,785
Pakësime	(616)	-	(616)
Vlera e amortizimit	(26,840)	(11,300)	(38,140)
Vlera kontabël më 31 janar 2021	93,516	26,840	120,356

Shtesat në aktivët me të drejtë përdorimi gjatë 2021 janë 31,785 mijë Lekë. (2020:36,295 mijë Lekë)

Detyrime për Qira	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Afatshkurtër	20,698	22,257
Afatgjatë	101,225	109,085
Total	121,923	131,342

Shpenzimet e interesit të përfshira në kostot financiare të vitit 2021 janë 4,532 mijë lekë (2020: 4,744 mijë lekë).

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

19. AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI (VAZHDIM)

Shpenzimet në lidhje me qiratë afatshkurtra dhe me qiratë e aktiveve me vlerë të ulët që nuk përfshihen në Akive me të drejtë përdorimi :

	2021	2020
Shpenzimet në lidhje me qiratë afatshkurtra	2,503	4,377
Shpenzimet në lidhje me qiratë e aktiveve me vlerë të ulët që nuk janë paraqitur më sipër si qira afatshkurtër	308	313

Fluksi ne dalje i parave për qiratë në vitin 2021 është 45,045 mijë lekë (2020: 47,172 mijë lekë).

20. INVESTIMET NË FILIALE

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
ALBA CEMENTO SH.P.K.	756,766	756,766
Zhvleresim i investimit në filiale	(526,180)	(526,180)
CEMENTI ANTEA SRL	599,345	599,345
	829,931	829,931

- Shoqëria zotëron 100% të kapitalit aksionar të ALBA CEMENTO SH.P.K. ALBA CEMENTO SH.P.K. zotëron një terminal për përpunim të çimentos në Tiranë, nëpërmjet të cilit ofron shërbime logjistike kundrejt ANTEA CEMENT SH.A.
- CEMENTI ANTEA SRL – Itali është një shoqëri bijë e zotëruar 100% nga Shoqëria. Aktiviteti kryesor i saj është tregëtimi i çimentos nëpërmjet terminalit të marrë me qira në Ortona, Itali.

21. AKTIVE TE TJERA AFATGJATA

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Aktive të tjera afatgjata	32,761	32,761
Provizione	(23,224)	(23,224)
	9,537	9,537

Lëvizjet në provizione për aktivet të tjera afatgjata tregohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja në 1 janar	23,224	23,224
Provizion gjatë vitit (shenim 3.5)	-	-
Gjendja në 31 dhjetor	23,224	23,224

Aktivitet e tjera afatgjata janë aktive, të marra nga Shoqëria përmes procedurës përmbarimore nga klientët të cilët ishin pjesë e këtyre procedurave.

Shoqëria pret të shesë pasuritë në të ardhmen e afërt. Më 31 dhjetor 2021 aktivet afatgjata të njohura në bazë të procedurës përmbarimore janë në vlerën 32,761 mijë Lekë. Për më tepër, Shoqëria ka njohur një provizion në vlerë 23,224 mijë Lekë.

22. INVENTARI

Inventari në Pasqyrën e Pozicionit Financiar analizohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Lënda e parë	950,579	327,290
Pjesë këmbimi	809,781	798,535
Materiale paketimi	118,082	52,771
Mallra gjysëm të gatshme	118,357	114,968
Mallra të gatshme	46,776	54,739
Mallra për rishitje	28,706	15,370
Materiale të tjera	101,684	106,806
Mallra në tranzit	-	69,592
Provizione për mallra	(49,218)	(48,430)
Totali	2,124,747	1,491,641

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

22. INVENTARI (VAZHDIM)

Lëvizjet në provizionet për inventarët janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	48,430	2,128
Shtesa në provizione gjatë periudhës	788	46,302
Gjendja me 31 dhjetor	49,218	48,430

23. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të arkëtueshme	713,857	890,236
Minus: Zbritja nga humbja e pritshme e kredisë (ECL)	(541,646)	(541,646)
Llogari të arkëtueshme neto	172,211	348,590

Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor midis 30-120 ditë.

Shoqëria zbaton modelin e thjeshtuar të SNRF 9 për llogaritjen e zhvlerësimeve të pritshme të llogarive të arkëtueshme, i cili parashikon pritshmërinë e humbjes gjatë të gjithë jetëgjatësisë në skemën e provizionimit të llogarive të arkëtueshme.

Lëvizjet në lidhje me provizionet për llogaritë e dyshimta janë si më poshtë. Modeli i ri nuk ka impaktuar provizionimin për zhvlerësim të shoqërisë nisur nga fakti që skema e provizionimit nuk ka ndryshuar në menyrë thelbësore.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	541,646	551,210
Kthimi i dëmtimit	-	(9,564)
Gjendja me 31 dhjetor	541,646	541,646

Përlllogaritja e Humbjes së Pritshme të Kredisë (ECL) në lidhje me llogaritë e arkëtueshme përcaktohen sipas skemës së matricës së provizionit të paraqitur në tabelën më poshtë:

Në % vlerës bruto	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	Përqindja e humbjes	Vlera bruto e mbartur	Jetëgjatësia ECL	Përqindja e humbjes	Vlera bruto e mbartur	Jetëgjatësia ECL
Të Arkëtueshme Tregtare						
- aktuale	13.1%	32,577	(4,262)	11.0%	98,842	(10,843)
- Deri në 30 ditë me vonesë	3.3%	71,588	(2,339)	3.0%	119,787	(3,618)
- 30-60 ditë me vonesë	2.1%	35,780	(735)	1.9%	39,652	(768)
- 61-90 ditë me vonesë	4.3%	2,889	(123)	4.4%	42,598	(1,860)
- 91-180 ditë me vonesë	4.8%	6,761	(326)	5.3%	28,095	(1,484)
- 181-360 ditë me vonesë	72.5%	19,963	(14,477)	74.4%	4,320	(3,215)
- mbi 361 ditë me vonesë	95.4%	544,299	(519,384)	93.3%	556,942	(519,858)
Totali i llogarive të arkëtueshme (vlerë bruto)		713,857			890,236	
Zhvlerësim për humbjen e kreditit			(541,646)			(541,646)
Llogari të arkëtueshme neto			172,211			348,590

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

24. TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogaritë e tjera të arkëtueshme në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime të shtyra	34,375	37,804
Debitorë të ndryshëm	21,207	23,492
Tatime të tjera për të arkëtuar	3,863	21,413
TVSH e arkëtueshme	169,602	12,447
Parapagimet për furnitorë	11,477	11,549
Provizion për aktive të tjera afat-shkurtra	(5,053)	(5,053)
Totali	235,471	101,652

Shpenzime të shtyra përfaqësojnë materiale dhe/ose shpenzime të parapaguara të cilat janë shtyrë për një periudhë kohe dhe janë shpenzuar në bazë të normës përkatëse të konsumit.

Lëvizjet në provizionet për aktivet e tjera afat-shkurtra janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendja më 1 janar	5,053	-
Shtesa gjatë vitit	-	5,053
Gjendja me 31 dhjetor	5,053	5,053

25. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË TË TYRE

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në pasqyrat financiare janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare në arkë në Lekë	42	64
Mjete monetare në arke në monedhë të huaj	104	105
Mjete monetare në bankë në Lekë	184,683	106,771
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	811,594	707,933
	996,423	814,873

26. KAPITALI I NËNSHKRUAR DHE I PAGUAR

Autorizuar, emëtuar dhe paguar plotësisht	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	Numri i aksioneve	% e pjesëmarrjes	Vlera nominale LEKË' 000	Numri i aksioneve	% e pjesëmarrjes	Vlera nominale LEKË' 000
ALVACIM Ltd aksione prej 2,000 Lekë secili	5,343,255	100%	10,686,510	5,343,255	100%	10,686,510
Totali	5,343,255	100%	10,686,510	5,343,255	100%	10,686,510

27. PLANI STIMULUES AFATGJATË

Plani 2020

Më 13 maj 2019, Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshëm e Titan Cement International S.A. (TCI) miratoi një plan të ri stimulues afatgjatë. Një vit më pas, më 14 maj 2020, Asambleje e Përgjithshme vjetore e TCI e përfshiu atë në Politikën e Shpërblimit.

Pjesëmarrësit e planit janë anëtarët ekzekutivë të Bordit të Drejtorëve të TCI, drejtuesit e TCI, si dhe drejtues të lartë në Shoqëritë e tjera të Grupit TITAN. Shpërblimet mund të jepen gjithashtu në mënyrë selektive për një numër të kufizuar të punonjësve të cilët dallohen vazhdimisht për performancën e tyre të jashtëzakonshme dhe potencialin e lartë për zhvillim.

Sipas planit, pjesëmarrësve u jepen shpërblime në aksione, pa pagesë në formën e një granti të kushtëzuar të aksioneve ne hije të TCI në prill (ose më vonë) të çdo viti. Shpërblimet në aksione nuk kanë të drejtë dividendi ose vote.

Numri i aksioneve fantazmë të dhëna për secilin pjesëmarrës përcaktohet nga shumata e dhënies dhe vlera e aksionit ne hije. Vlera e aksionit ne hije është e barabartë me çmimin mesatar të mbylljes së aksionit të TCI në Euronext Bruksel gjatë shtatë ditëve të fundit të tregimit të Marsit të vitit të grantit.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

27. PLAN STIMULUES AFATGJATË (VAZHDIM)

Periodha e dhënies/përfitimit të shpërblimeve është si më poshtë:

- 50% në përfundim të një periudhe tre vjeçare dhe
- 50% në përfundim të një periudhe katër vjeçare

Shpërblimet përfitohen në datat e caktuara, me kusht që pjesëmarrësit të jenë ende duke punuar në TCI ose në ndonjë Shoqëri tjetër punëdhënëse të Grupit, ose janë ende duke shërbyer si Drejtor ekzekutiv në Bordin e Drejtorëve të TCI.

Pas përfitimit të shpërblimit, pjesëmarrësit mund të zgjedhin të marrin shpërblimet e tyre nëpërmjet aksioneve të TCI, ose si një kontribut në një fond, ose në të holla. Shoqëria mëmë e Grupit TITAN (Titan Cement International S.A.) ka detyrimin të shlyejë shpërblimet.

Kështu, Antea Cement e llogarit planin si një transaksion të shlyer në aksione duke njohur në zërat e Kapitalit dhe Rezervave, vlerën e drejtë të shërbimeve që merr nga pjesëmarrësit.

Më 31 dhjetor 2020, numri i aksioneve të dhëna punonjësve të Antea Cement ishte 6,370.

Vlera e drejtë e shpërblimit është llogaritur bazuar në çmimin mbyllës të aksionit TCI më 14/05/2020, prej 10.82 Euro në Euronext Bruksel. Llogaritja e çmimeve të pafituara rezultoi në njohjen e një shpenzimi prej 1,826 mijë Lekë me një rritje korresponduese të kapitalit neto.

Plani 2021

Më 14 maj 2021, Asambleja e Përgjithshme Vjetore e TCI miratoi planin e mëposhtëm.

Pjesëmarrësit e planit janë anëtarët ekzekutivë të Bordit të Drejtorëve të TCI, drejtuesit e TCI, si dhe drejtues të lartë në Shoqëritë e tjera të Grupit TITAN. Shpërblimet mund të jepen gjithashtu në mënyrë selektive për një numër të kufizuar të punonjësve të cilët dallohen vazhdimisht për performancën e tyre të jashtëzakonshme dhe potencialin e lartë për zhvillim.

Sipas planit, pjesëmarrësve u jepen shpërblime në aksione, pa pagesë në formën e një granti të kushtëzuar të aksioneve hije të TCI në prill (ose më vonë) të çdo viti. Shpërblimet në aksione nuk kanë të drejtë dividendi ose vote.

Numri i aksioneve hije të dhëna për secilin pjesëmarrës përcaktohet nga shuma e dhënies dhe vlera e aksionit në hije. Vlera e aksionit hije është e barabartë me çmimin mesatar të mbylljes së aksionit të TCI në Euronext Bruksel gjatë shtatë ditëve të fundit të tregtimit të Marsit të vitit të grantit.

Periodha e dhënies/përfitimit të shpërblimeve është si më poshtë:

- 50% në përfundim të një periudhe tre vjeçare dhe
- 50% në përfundim të një periudhe katër vjeçare

Shpërblimet përfitohen në datat e caktuara, me kusht që pjesëmarrësit të jenë ende duke punuar në TCI ose në ndonjë Shoqëri tjetër punëdhënëse të Grupit, ose janë ende duke shërbyer si Drejtor ekzekutiv në Bordin e Drejtorëve të TCI.

Pas përfitimit të shpërblimit, pjesëmarrësit mund të zgjedhin të marrin shpërblimet e tyre nëpërmjet aksioneve të TCI, ose si një kontribut në një fond, ose në të holla. Shoqëria mëmë e Grupit TITAN (Titan Cement International S.A.) ka detyrimin të shlyejë shpërblimet.

Kështu, Antea Cement e llogarit planin si një transaksion të shlyer në aksione duke njohur në zërat e Kapitalit dhe Rezervave, vlerën e drejtë të shërbimeve që merr nga pjesëmarrësit.

Më 31 dhjetor 2021, numri i aksioneve të dhëna punonjësve të Antea Cement ishte 4,410.

Vlera e drejtë e shpërblimit është llogaritur bazuar në çmimin mbyllës të aksionit TCI më 13/05/2021, prej 17.14 Euro në Euronext Bruksel. Llogaritja e çmimeve të pafituara rezultoi në njohjen e një shpenzimi prej 4,389 mijë Lekë me një rritje korresponduese të kapitalit neto.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

27. PLAN STIMULUES AFATGJATË (VAZHDIM)

Levizja në numrin e aksioneve për shpërblim është si më poshtë :

31 dhjetor 2019	Plani 2021	Plani 2020
Shpërndarë	-	6,370
Ushtruar	-	-
Anulluar	-	-
31 dhjetor 2020		6,370
Shpërndarë	4,410	-
Ushtruar	-	-
Anulluar	-	-
31 dhjetor 2021	4,410	6,370

Shpërblimet në fund të vitit kanë këto karakterisitka:

Cmimi ushtrimit zero	2021 PSA	2020 PSA
Data e skadencës		
2023	-	3,185
2024	2,205	3,185
2025	2,205	-
Total	4,410	6,370

28. HUAMARRJET

A) HUAMARRJE AFATGJATA

Huamarrjet afatgjata të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Huamarrje nga Palët e Lidhura		
Kredi me afat	5,594,974	7,648,538
Huamarrje nga Institucionet Financiare		
Kredi me afat	1,534,670	1,836,868
Totali	7,129,644	9,485,406

Vlera kontabël e huave përafrohet me vlerën e drejtë duke qënë që huatë janë dhënë me norma të tregut. Informacion i mëtejshëm për huamarrjet nga palët e lidhura/aksionerët mund të gjendet në shënimin 32.

Gjithashtu, më tepër informacion mbi huatë afatgjatë të shoqërisë i gjeni si më poshtë:

RAIFFISEN BANK ALBANIA

Më 11 shkurt 2020 Shoqëria ka rënë dakord për një kredi të re afatgjatë me Raiffeisen Bank Albania (RBAL) në vlerën Lekë ekuivalent 17,000 mijë Euro me maturim deri në vitin 2024. Nga vlera e disponueshme Shoqëria ka shfrytëzuar vlerën 16,000 mijë Euro ose 1,968,900 mijë Lekë. Kjo kredi është përdorur për të rifinancuar kredinë nga aksionerët e Shoqërisë. Kredia e re sigurohet nga një garanci korporative e Titan Cement Company SA dhe Titan Cement International SA.

Më 31 dhjetor 2021 shuma e principalit është 1,523,425 mijë Lekë nga të cilat 1,052,867 mijë Lekë afatgjata dhe 470,558 mijë lekë afatshkurtra. (31 dhjetor 2020: 1,993,982 mijë Lekë nga të cilat 1,523,425 mijë Lekë afatgjata dhe 470,558 mijë Lekë afatshkurtra).

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

28. HUAMARRJET (VAZHDIM)

A) HUAMARRJE AFATGJATA (VAZHDIM)

Gjatë vitit Shoqëria ka paguar vlerën prej 470,558 mijë Lekë principal sipas planit të dakordësuar (2020: 384,418 mijë Lekë).

Më 25 maj 2021 Shoqëria ra dakord me Raiffeisen Bank për të zgjatur maturimin e huasë për kapital qarkullues deri në shkurt 2023. Në 31 dhjetor 2020 kredia në vlerën 276,000 mijë lekë është e shfrytëzuar në vlerën 252,556 mijë lekë dhe shuma e pashfrytëzuar është 23,444mijë lekë. (31 dhjetor 2020 kredia është e pashfrytëzuar, dhe e disponueshme për Shoqërinë.

Me 25 maj 2021 Shoqëria ra dakord me Raiffeisen Bank për të zgjatur maturimin e huasë në vlerën prej 1.3 milion Euro me maturim deri në shkurt 2024 për tu përdorur ekskluzivisht për lëshimin e garancive bankare dhe/ose letër kredive. Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 kjo linjë kredie është e papërdorur.

ALPHA BANK ALBANIA

Më 3 qershor 2021, Shoqëria ka rënë dakord për një kredi të re afatgjatë me Alpha Bank me vlerë 620,000 mijë Lekë me afat maturimi deri në 2025. Shuma është disbursuar plotësisht dhe është përdorur për të rfinansuar huamarrjen me Titan Global Finance plc. Kredia është e siguruar me garanci korporative nga Titan Cement International S.a.

Më 31 dhjetor vlera e principalit të pashlyer arrin në vlerën 957,569 mijë lekë nga të cilat 535,000 mijë Lekë hua afatgjatë dhe 422,569 mijë Lekë hua afatshkurtër (31 dhjetor 2020: 567,829 mijë lekë nga të cilat 337,569 mijë Lekë hua afatgjatë dhe 230,260 mijë Lekë hua afatshkurtër).

Gjatë vitit Shoqëria ka paguar Alpha Bank vlerën 230,260 mijë Lekë sipas planit të ripagimit të rënë dakord (2020: 230,260 mijë Lekë).

Më 7 mars 2019, Shoqëria ra dakord me Alpha Bank që të zgjasë afatin e huasë për kapital qarkullues edhe për 3 vite të tjera nga data e nënshkrimit. Më 31 dhjetor 2021 huaja është e shfrytëzuar në vlerën 225,008 mijë Lekë dhe pjesa e mbetur prej 231,923 mijë lekë mbetet e pashfrytëzuar dhe në dispozicion të Shoqërisë (31 dhjetor 2020 limiti është i pashfrytëzuar dhe i disponueshëm për kompaninë)

Te dyja linjat e kredisë janë të siguruara me garanci korporative nga Titan Cement Company S.a.

Maturimet e huamarrjeve afatgjata janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Më shumë se 1 vit por më pak se 2 vjet	1,030,901	1,208,802
Më shumë se 2 vjet por më pak se 5 vjet	6,098,743	8,276,604
Mbi 5 vjet	-	-
Totali	7,129,644	9,485,406

B) HUAMARRJET AFATSHKURTRA

Huamarrjet afatshkurtra dhe pjesa afatshkurtër e huamarrjeve afatgjata është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Huamarrje nga Palët e Lidhura		
Kredi me afat	538,677	569,037
Huamarrje nga Institucionet Financiare		
Kredi për kapital qarkullues	477,564	-
Kredi me afat	902,256	709,376
Totali	1,918,497	1,278,413

Informacioni i mëtejshëm për huamarrjet nga palët e lidhura/aksionerët mund të gjendet në Shënimin 31.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

29. RAKORDIMI I DETYRIMEVE NGA AKTIVITETET FINANCIARE

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të detyrimeve nga aktivitetet financiare dhe lëvizjet në detyrimet e Kompanisë nga aktivitetet financiare për secilën nga periudhat e paraqitura. Zërat e këtyre detyrimeve janë ata që raportohen si financim në pasqyrën e flukseve monetare:

	31 dhjetor 2021			31 dhjetor 2020		
	Huatë	Detyrimet e qirasë	Totali	Huatë	Detyrimet e qirasë	Totali
Detyrime nga aktiviteti financiar më 1 Janar	10,763,819	131,342	10,895,161	12,420,203	131,040	12,551,243
Fluket monetare:						
Fonde të marra nga huatë	1,097,564	-	1,097,564	11,121,318	-	11,121,318
Shlyerja e huave	(2,602,844)	-	(2,602,844)	(12,957,175)	-	(12,957,175)
Interesa të paguara	(382,129)	-	(382,129)	(323,901)	-	(323,901)
Pagesa për tarifa	(59,024)	-	(59,024)	(57,699)	-	(57,699)
Pagesa për qiratë	-	(37,704)	(37,704)	-	(37,738)	(37,738)
Ndryshime jo monetare						
Shpenzime interesi	414,697	-	414,697	592,403	-	592,403
Qiratë e reja	-	31,785	31,785	-	36,295	36,295
Ndryshime nga kursi i këmbimit	(164,426)	(2,884)	(167,310)	(37,246)	2,290	(34,956)
Të tjera	(19,516)	(616)	(20,132)	5,917	(545)	5,372
Detyrime nga aktiviteti financiar më 1 dhjetor	9,048,141	121,923	9,170,064	10,763,819	131,342	10,895,161

30. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme nuk mbartin interes dhe janë me furnitorët vendas dhe të huaj dhe shlyhen në një hark kohor prej 30 deri në 90 ditë.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të pagueshme ndaj palëve të treta	1,544,262	840,703
Detyrime të përlllogaritura ndaj furnitorëve	13,095	29,767
Totali	1,557,357	870,470

31. TË TJERA TË PAGUESHME

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Parapagime nga klientët	47,273	42,426
Taksa të tjera	63,962	35,206
Provizione të tjera	25,431	21,425
Detyrime për kontributet ndaj sigurimeve shoqërore	4,978	4,677
Të tjera të pagueshme	3,776	4,391
Tatime mbi pagat	2,497	2,668
Detyrime ndaj punonjësve	182	1,356
Totali	148,099	112,149

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

31. TË TJERA TË PAGUESHME (VAZHDIM)

Provizione të tjera lidhet me provizione për lejet e papërdorura, provizione për kosto të tjera në lidhje me personelin, si dhe provizione të tjera operacionale, etj. Lëvizja e provizioneve paraqitet si më poshtë:

	Provizion për kosto shtesë personeli	Provizion për lejet e papërdorura	Totali
Balanca më 1 janar 2020	6,980	10,800	17,780
Shtesa	1,685	1,960	3,645
Balanca më 31 dhjetor 2020	8,665	12,760	21,425
Shtesa	2,269	1,737	4,006
Balanca më 31 dhjetor 2021	10,934	14,467	25,431

32. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA

Shoqëria kontrollohet nga Alvacim Ltd e cila është një shoqëri e kontrolluar nga Titan Cement International SA. Shoqëria konsideron si palë të lidhura të gjitha shoqëritë e Grupit Titan që kontrollohen nga Titan Cement International SA.

Tabelat e mëposhtme japin një pamje të shumave dhe transaksioneve që Shoqëria ka kryer me palët e lidhura gjatë vitit financiar.

A) Shitje produktesh dhe shërbimesh

	2021	2020
TCK Montenegro – (Shitje çimentoje)	652,910	688,321
Cementi Antea Srl - (Shitje çimentoje)	817,369	437,223
Sharrcem- (Shitje Klinker)	22,901	40,866
Sharrcem- (Shitje të tjera)	8,132	8,399
Cement Plus - (Shitje çimentoje)	37,583	60,090
Cementarnica Usje	-	2,077
Cementara Kosjeric - (Shitje Klinker)	12,302	1,844
Alba Cemento Sh.p.k. (Shitje e aktiveve aftagjata)	73	154
Titan Cement Company S.A	2,193	132
Totali	1,553,463	1,239,106

Transaksionet kryesore që kryhen me Cementi Antea Srl dhe TCK Montenegro konsistojnë në shitjen e çimentos. (31 dhjetor 2020: Transaksionet kryesore që kryhen me Cementi Antea Srl dhe TCK Montenegro konsistojnë në shitjen e çimentos).

B) Të arkëtueshme nga palët e lidhura

Balancat e arkëtueshme që rrjedhin nga transaksionet e përmendura më sipër janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Cementi Antea srl	214,154	170,753
Sharrcem	6,833	41,181
TCK Montenegro	3,898	17,309
Titan Cement Company SA	416	132
Cement Plus	10	11
Titan Cementara Kosjeric	907	-
Totali	226,218	229,386

Balanca kryesore për t'u arkëtuar nga palët e lidhura lidhen me Cementi Antea Srl dhe TCK Montenegro për çimento të shitur dhe Sharrcem për Klinker të shitur.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

32. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA(VAZHDIM)

C) Blerje e Mallrave dhe Shërbimeve

	2021	2020
Titan Cement Company sa– (Blerje mallrash)	16,786	12,945
Titan Cement Company sa – (Shërbime)	547,061	428,494
Alba Cemento shpk- (Shërbime)	15,704	22,277
Cementarnica Usje Ad Skopje	8,368	13,566
TCK Montenegro – (Blerje Mallrash)	-	138
Zlatna Panega Cement	166	1,931
Totali	588,085	479,351

Blerjet kryesore gjatë vitit janë bërë nga Titan Cement S.A. për shërbime dhe mallra të ndryshme (2020: Blerjet kryesore gjatë vitit janë bërë nga Titan Cement S.A. për shërbime dhe mallra të ndryshme).

D) Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Balancat e hapura që vijnë nga transaksionet e sipërpërmendura janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Titan Cement Company S.A.	279,787	171,967
Albacemento shpk	77,247	79,807
Cementarnica Usje Ad Skopje	6,500	7,453
Zlatna Panega Cement	-	2,490
Cementi Antea SRL	-	138
Totali	363,534	261,855

E) Hua nga palët e lidhura/aksionerët

Huamarrje Afatgjata

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Titan Global Finance plc	5,594,974	7,648,538
Totali	5,594,974	7,648,538

Gjatë 2008-ës, Shoqëria ka hyrë në disa marrëveshje huaje me aksionerët e vet për të financuar ndërtimin e fabrikes së çimentos në Boka Kuqe, Borizanë.

Pas blerjes së aksioneve të BERZH në Shoqëri, nga Alvacim Ltd, më 20 janar 2015, Alvacim Ltd rfinansoi kredinë aksionere të dhënë nga BERZH me të njëjtat terma dhe kushte.

Pas blerjes së aksioneve të IFC në Shoqëri, nga Alvacim Ltd, më 17 dhjetor 2019 Alvacim Ltd rfinansoi kredinë aksionere të dhënë nga IFC me të njëjtat terma dhe kushte.

Gjatë vitit 2020 Shoqëria ka shlyer principalin e huasë karshi aksionerit të saj (Alvacim Ltd) në vlerën prej 19,000 mijë Euro ose ekuivalentin e 2,313,630 mijë Lekë, e cila pjesërisht u rfinansua nga kredia e marrë nga banka Raiffeisen dhe pjesërisht nga likuiditetet e vetë Shoqërisë.

Më 10 prill 2020, Shoqëria nënshkroi dhe ekzekutoi një Marrëveshje Kredie me afat, me Titan Global Finance plc (një Shoqëri e Grupit TITAN) për të rfinansuar borxhin e mbetur nga kredia e aksionerit prej 72,831 mijë Euro. Kredia me afat ka një maturim prej 5 vjetësh. Rfinansimi i shumës së mësipërme u ekzekutua midis datave 14 dhe 15 prill 2020.

Për më tepër më 10 prill 2020, Shoqëria nënshkroi një marrëveshje për një hua për kapital qarkullues me Titan Global Finance plc (një Shoqëri e Grupit TITAN) në vlerën prej 10 milion Euro që do të përdoret për financimin e përgjithshëm të kapitalit qarkullues të shoqërisë dhe që ka një maturim deri më 30 janar 2022. Deri më sot, kjo kredi nuk është përdorur dhe është në dispozicion të Shoqërisë.

Gjatë vitit 2021 Shoqëria ka shlyer principalin e huasë karshi Titan Global Finance plc në vlerën 15,500 mijë Euro ose ekuivalentin e 1,902,026 mijë Lekë (2020: Principal në vlerën 7,000 mijë Euro ose ekuivalentin e 867,680 mijë Lekë) dhe interesat dhe tarifat përkatëse në vlerën 2,303 mijë Euro ose ekuivalentin e 282,609 mijë Lekë (2020: Interesa dhe tarifa përkatëse në vlerën 1,767 mijë Euro ose ekuivalentin e 219,363 mijë Lekë)

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

30. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA(VAZHDIM)

E) Hua nga palët e lidhura/aksionerët (vazhdim)

Huamarrje Afatshkurtra

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Titan Global Finance plc	483,040	494,800
Titan Global Finance plc interesi i përlogaritur	55,637	74,237
Totali	538,677	569,037

Shpenzimet për interesa

	2021	2020
Shpenzime për interesa për Alvacim	-	204,855
Shpenzime për interesa për Titan Global Finance plc	315,448	287,936
Totali	315,448	492,791

Përveç përfitimeve afatshkurtra ndaj drejtuesve kryesorë të Shoqërisë, në vlerën 49,156 mijë Lekë (2020: 48,226 mijë Lekë), nuk janë dhënë kompensime të tjera ndaj drejtuesve kryesorë nga Shoqëria.

Natyra e marrëdhënies me palët e lidhura

Shoqëria ka hyrë në këto transaksione me palët e lidhura të mësipërme në terma të rënë dakord bashkarisht.

Termet dhe kushtet e transaksioneve me palët e lidhura

Shitjet dhe blerjet nga palët e lidhura janë kryer me çmime normale tregu. Tëpricat në fund të vitit janë të pasiguruar, nuk mbartin interes dhe shlyerjet e tyre kryhen me mjete monetare. Nuk janë dhënë dhe nuk janë marrë garanci për llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme nga palët e lidhura. Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2021, Shoqëria nuk ka krijuar provizion për llogari të arkëtueshme të dyshimta lidhur me vlerat që priten të arkëtohen nga palët e lidhura (31 dhjetor 2020: zero). Ky vlerësim është kryer çdo vit financiar, duke shqyrtuar pozicionin financiar të palëve të lidhura dhe tregut në të cilin operon pala e lidhur.

33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT

Shoqëria ka ekspozim kundrejt rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut nga përdorimi i instrumentave financiarë.

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme; objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për të matur dhe manaxhuar rrezikun, si dhe manaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime të mëtejshme shpjeguese sasiore janë përfshirë në pasqyrat financiare dhe veçanërisht në **shënimin 31**. Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikqyrjen e strukturës së Shoqërisë për manaxhimin e rrezikut.

Politikat e Shoqërisë për manaxhimin e riskut janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rrezikun me të cilat përballet Shoqëria, për të përcaktuar kufij dhe kontrolle rreziku të përshtatshme, si dhe për të monitoruar rrezikun dhe zbatimin e kufijve të përcaktuar. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet e kushteve të tregut dhe të aktiviteteve të Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve, procedurave dhe standardeve të manaxhimit ka për qëllim të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin punonjësit kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesorë financiarë të Shoqërisë lidhen me mjetet monetare në arkë ose bankë, huatë nga palët e lidhura, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, si dhe llogari të tjera të arkëtueshme dhe të pagueshme.

- **Rreziku i tregut**

Rreziku i normës së interesit

Shoqëria përballet me rrezikun e normës së interesit që lidhet me huatë të cilat kanë një normë të ndryshueshme. Manaxhimi nuk mban instrumente derivuese për të zbutur rrezikun.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria ka një ekspozim të madh kundrejt monedhave të huaja. Shoqëria ka hua afatshkurtra dhe afatgjata në Euro.

ANTEA CEMENT SH.A. SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)

• Rreziku i likuiditetit

Shoqëria gjeneron fluks mjeteve monetare nga aktivitetet operative dhe beson se rreziku i likuiditetit nuk është i rëndësishëm.

• Rreziku i kredisë

Për shkak të volumit të madh dhe shumëllojshmërisë së bazës së klientëve të Shoqërisë, përqëndrimet e rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme nga klientët janë të limituar. Provizioni për llogaritë e dyshimta përcaktohet në një vlerë e cila konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqe potenciale në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.

Analiza e ndjeshmërisë

Përgjatë manaxhimit të rrezikut të normës së interesit dhe kursit të këmbimit, Shoqëria ka për qëllim uljen e ndikimit të luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në periudhë afatgjata, megjithatë, ndryshimet e përhershme të kursit të këmbimit dhe normës së interesit kanë një impakt në fitim. Ju lutem referojuni analizës së ndjeshmërisë në shënime 33a dhe 33b.

(iv) Manaxhimi i kapitalit

Politika e shoqërisë është që të mbajë një bazë kapitali të fortë, si dhe të ketë besimin e investitorit, kreditorit dhe tregut për të mbështetur zhvillimet e biznesit në të ardhmen. Bordi i Drejtorëve monitoron fitimet përpara interesave, tatimeve dhe amortizimit.

Bordi po mundohet të mbajë një ekuilibër midis kthimeve të larta të cilat mund të arrihen me nivele më të larta huash, dhe avantazheve nga siguria e të pasurit një pozicion të mirë kapitali. Detajet e përlogaritjes së FPITA jepen në shënimin 35.

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashtme për kapitalin.

Nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit në trajtimin e manaxhimit të rrezikut financiar dhe kapitalit nga Shoqëria.

Instrumentat kryesorë financiarë të Shoqërisë përbëhen nga kredi bankare dhe hua afatshkurtra, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra. Qëllimi kryesor i këtyre instrumentave financiarë është të sigurojë financim për aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria ka edhe disa aktive dhe detyrime financiare të tjera si për shembull llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme, që rrjedhin direkt nga aktivitetet e saj. Manaxhimi i rrezikut kryhet sipas politikave të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Rreziqet kryesorë që rrjedhin nga instrumentet financiare të Shoqërisë janë rreziqet e likuiditetit, rreziqet e kurseve të këmbimit dhe rreziku i kreditit.

Manaxhimi rishikon dhe aprovon politikat për menaxhimin e secilit prej këtyre rreziqeve të cilat janë përmbledhur më poshtë.

a) Rreziku i normave të interesit

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut për ndryshime në normat e interesit të tregut lidhet kryesisht me huamarrjet afatgjata të Shoqërisë që janë me normë interesi të ndryshueshme. Më 31 dhjetor 2021 (31 dhjetor 2020, zero) Shoqëria nuk ka lidhur asnjë marrëveshje "swap" për normat e interesit, gjë që shkakton që 100% e huamarrjeve të Shoqërisë të jenë me normë të ndryshueshme interesi.

	31 dhjetor 2021	31 Dhjetor 2019
Instrumentat me normë interesi fikse		
Aktive financiare	-	-
Detyrime financiare	-	-
Instrumentat me normë interesi të ndryshueshme	9,048,141	10,763,819
Aktive financiare	-	-
Detyrime financiare	9,048,141	10,763,819

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)

a) Rreziku i normave të interesit (vazhdim)

Të ardhurat dhe flukset monetare operative të Shoqërisë janë në mënyrë të konsiderueshme të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut, gjithsesi efekti ndryshimit në normat e interesit mbi huamarrjet afatgjata të Shoqërisë, do të kishte efektin e mëposhtëm në fitim-humbjen para tatimit të Shoqërisë:

Në Lekë'000	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
	Rritje/ulje në pikë bazë	Efekti në fitim/humbje para tatimit	Rritje/ulje në pikë bazë	Efekti në fitim/humbje para tatimit
EURO	20	11,190	20	15,297
LEKË	100	15,347	100	18,369
EURO	(20)	(11,190)	(20)	(15,297)
LEKË	(100)	(15,347)	(100)	(18,369)

b) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria hyn në transaksione në valutë të huaja në lidhje me shitjen e produkteve të saj dhe blerjen e aktiveve fikse dhe blerjen e mallrave tregtare nga palët e lidhura. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument të veçantë financiar kundër këtyre rreziqeve, duke qënë se nuk ka instrumente të tilla në përdorim të gjërë në Republikën e Shqipërisë. Prandaj, Shoqëria është e ekspozuar potencialisht ndaj rreziqeve të tregut që lidhen me luhatje të mundshme të kurseve të këmbimit të valutave të huaja.

	31 dhjetor 2021		
	Aktivët financiarë monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto në bilanc
Lekë	416,576	(4,459,994)	(4,043,418)
Euro	996,838	(6,790,221)	(5,793,383)
USD	216,909	(4,765)	212,144
Totali	1,630,323	(11,254,980)	(9,624,657)

	31 dhjetor 2020		
	Aktivët financiarë monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto në bilanc
Lekë	202,324	(3,322,294)	(3,119,970)
Euro	1,251,943	(8,883,564)	(7,631,621)
USD	40,234	(4,765)	35,469
Totali	1,494,501	(12,210,623)	(10,716,122)

Kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

EURO/LEKË	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2021	2020	2021	2020
	122.52	123.74	120.76	123.70

Ekspozimi kryesor ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është ndaj monedhës Euro. Si rrjedhojë, një ndryshim pres +/- 5% në kursin e këmbimit të Euros ndaj Lekut në datën e raportimit do ta kishte rritur / (ulur) kapitalin e vet dhe fitimin me 289,669 mijë Lekë (2020 – 381,581 mijë Lekë).

c) Rreziku i Likuiditetit

Politika e kujdesshme e manaxhimit të rrezikut të likuiditetit nënkupton ruajtjen e mjeteve monetare të mjaftueshme dhe disponueshmërinë e fondeve me anë të një sasive të mjaftueshme linjash krediti. Tabela më poshtë përmbledh profilin e maturimit të detyrimeve financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, bazuar në pagesat kontraktuale të paskontuara.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

33. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR, OBJEKTIVAT DHE POLITIKAT (VAZHDIM)

c) Rreziku i Likuiditetit (vazhdim)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Të pagueshme menjëherë	Më pak se 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Huamarrje Afatgjata	-	-	-	7,701,925	-	7,701,925
Huamarrje Afatshkurtra	-	419,088	1,743,268	-	-	2,162,356
Llogari të pagueshme dhe të tjera	-	1,721,382	384,232	62,007	39,218	2,206,839

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Të pagueshme menjëherë	Me pak se 3 muaj	3 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	> 5 vjet	Totali
Huamarrje Afatgjata	-	-	-	10,606,818	-	10,606,818
Huamarrje Afatshkurtra	-	400,894	1,185,304	-	-	1,586,198
Llogari të pagueshme dhe të tjera	-	1,053,607	284,112	61,523	47,562	1,446,804

d) Rreziku i kreditit

Shoqëria nuk ka përqëndrime të rëndësishme të rrezikut të kredisë. Shoqëria ka aprovuar politika të tilla krediti për të siguruar që shitja e produkteve të bëhet për klientët me një histori krediti të përshtatshme. Shoqëria ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë për çdo klient. Përveç kësaj, për të zvogëluar këtë rrezik Shoqëria ka kërkuar si kolateral garanci bankare dhe depozita bankare. Rreziqet e njohura janë marrë parasysh duke krijuar provizione për zhvleresimin e llogarive të arkëtueshme.

Në lidhje me rreziqet e kreditit që rrjedhin nga aktivet e tjera financiare të Shoqërisë, të cilat përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre si dhe llogari të tjera të arkëtueshme afatshkurtra të Shoqërisë, ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit lind nga vonesa e palës tjetër, me një ekspozim maksimal të barabartë me vlerën kontabël të këtyre instrumenteve.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të arkëtueshme nga klientët dhe llogari të tjera të arkëtueshme (Shënimi 23, 24)	407,682	450,242
Mjete monetare në arkë dhe bankë (Shënimi 25)	996,423	814,873
Totali	1,404,105	1,265,115

34. VLERA E DREJTË

Vlera e drejtë e aktiveve afatshkurtra dhe detyrimeve afatshkurtra duke u nisur nga natyra afatshkurtër përafrohet me vlerën e tyre të mbartur. Vlera e drejtë e huave afatgjata gjithashtu përafrohet me vlerën e mbartur meqënëse ato mbartin interesa të ndryshueshëm.

Më poshtë është paraqitur një krahasim sipas klasave midis vlerës së mbartur dhe vlerës së drejtë të instrumentave financiarë që gjenden në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Aktive financiare	Vlera e mbetur		Vlera e drejtë	
	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare në arkë dhe bankë	996,423	814,873	996,423	814,873
Llogari të arkëtueshme	172,211	348,590	172,211	348,590
Llogari të arkëtueshme ndaj palëve të lidhura	226,218	229,386	226,218	229,386
Llogari të tjera të arkëtueshme	235,471	101,652	235,471	101,652
Totali	1,630,323	1,494,501	1,630,323	1,494,501

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

34. VLERA E DREJTË (VAZHDIM)

Detyrime financiare	Vlera e mbetur		Vlera e drejtë	
	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të pagueshme	1,557,357	870,470	1,557,357	870,470
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	363,534	261,855	363,534	261,855
Hua afatshkurtra	1,918,497	1,278,413	1,918,497	1,278,413
Detyrime per qira	121,923	131,342	121,923	131,342
Detyrime të tjera	148,099	112,149	148,099	112,149
Tatimi mbi të ardhurat	15,926	70,988	15,926	70,988
Hua afatgjata	7129,644	9,485,406	7,129,644	9,485,406
Totali	11,254,980	12,210,623	11,254,980	12,210,623

Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare janë përfshirë në vlerën në të cilën instrumenti mund të shkëmbehet në një transaksion ndërmjet palëve të interesuara përveçse në likujdime ose në shitje të detyruara. Metodat dhe supozimet e mëposhtme janë përdorur për të përcaktuar vlerën e drejtë:

- Mjetet monetare dhe depozitat afatshkurtra, llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, dhe detyrime të tjera afatshkurtra i përafrojnë vlerat e tyre të mbartura më së shumti duke u nisur nga natyra afatshkurtër e këtyre instrumentave.
- Huamarrjet afatgjata dhe aktivet afatgjata që mbartin normë fikse si dhe normë të ndryshueshme interesi vlerësohen nga Shoqëria duke u bazuar në parametra si norma e interesit, faktorë rreziku specifik të vendit si dhe në besueshmërinë e klientit. Duke u bazuar në këtë vlerësim, provizionet janë marrë parasyshtë për gjatë llogaritjes të humbjeve të mundshme të këtyre llogarive të arkëtueshme. Më 31 dhjetor 2020 vlera e mbartur e këtyre llogarive të arkëtueshme/huamarrjeve minus provizionet përkatëse nuk kanë ndryshime materiale nga vlera e drejtë e përlogaritur.

Hierarkia e Vlerës së Drejtë

Drejtimi i Shoqërisë ka gjykuar që duke qënë se vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë përafrohet me vlerën e tyre të mbartur, asnjë teknikë vlerësimi nuk është aplikuar për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiare të Shoqërisë. Këto gjykime futen në nivelin e 3 hierarkik, duke qënë se nuk ka informacione të jashtme të rëndësishme.

35. MANAXHIMI I KAPITALIT

Objektivi kryesor i manaxhimit të kapitalit të Shoqërisë është që të sigurohet se ajo ka një vlerësim të fortë përse i përket rrezikut të kreditit dhe gjithashtu të ketë raporte të shëndetshme të kapitalit në mënyrë që të mbështesin ecurinë e biznesit të tyre dhe të rrisin në nivele maksimale pasurinë e aksionerëve.

Shoqëria manaxhon kapitalin dhe strukturën e saj dhe bën rregullimet e nevojshme, në varësi të ndryshimeve të kushteve ekonomike. Për të ruajtur apo për të rregulluar strukturën e kapitalit, Shoqëria mund të rregullojë pagesën e dividendëve për aksionerët, t'i kthejë kapitalin aksionerëve apo të emetojë aksione te reja, sipas miratimit të aksionerëve.

Nuk ka pasur ndryshime në qëllimet, politikat ose proceset gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe në vitin aktual 2021. Shoqëria mbikqyr performancën ekonomike duke përdorur fitimin operativ para interesave, taksave, amortizimit dhe zhvleresimeve (EBITDA). EBITDA për vitet 2021 dhe 2020 është si më poshtë.

	2021	2020
Fitimi operativ para interesave, taksave, dhe zhvleresimeve	1,503,830	1,775,528
Shpenzimet e amortizimit	946,555	940,409
EBITDA	2,450,385	2,715,937

Shoqëria nuk i nënshtrohet ndonjë kërkesë për kapital të vendosur nga jashtë. Struktura dhe manaxhimi i kapitalit është vendosur nga Grupi TITAN.

ANTEA CEMENT SH.A.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Vlerat në mijë Lekë, nëse nuk është shprehur ndryshe)

36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

A) TATIMI

Pozicioni i pasigurt i Shoqërisë përsa i përket taksave është vlerësuar nga drejtimi i Shoqërisë në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet për tatim fitimin janë regjistruar nga drejtimi i Shoqërisë duke u bazuar në gjykimin që nuk do të rezultojnë detyrime shtesë në rast se këto detyrime kontrollohen nga organet tatimore. Vlerësimi është bërë në bazë të interpretimit të ligjeve tatimore që janë në fuqi në fund të periudhës tatimore si dhe çdo vendimi të ngjashëm në këto çështje. Detyrimet për penalitete, interesa dhe tatime të tjera njihen në bazë të vlerësimit të drejtimit për shpenzimin që do të nevojitet për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese dhe jo mbi të ardhurat e gjeneruara.

B) PROCESHE GJYQËSORE

Shoqëria është e përfshirë në çështje të ndryshme gjyqësore gjatë aktiviteteve të saj të biznesit. Çështjet materiale në të cilat Shoqëria është e përfshirë janë si më poshtë:

Ne 31 dhjetor 2021, Shoqëria është përfshirë në një proces gjyqësor ndaj një pale të tretë në lidhje me kostot e ndërtimit të një rruge hyrëse në përdorim nga Shoqëria e ndërtuar në vitin 2010. Çështja u shqyrtua nga Gjykata e shkallës së parë e Rrethit Krujë, e cila vendosi që të pranonte pjesërisht padinë.

Vlera totale e detyrimit për tu paguar është në vlerën 68,000 mijë Lekë. Shoqëria apeloj vendimin pranë Gjykatës së Apelit Tiranë e cila anuloi vendimin e Gjykatës së Rrethit Krujë, duke e dërguar çështjen për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Krujë. Kundër këtij vendimi Shoqëria apeloj pranë Gjykatës së Lartë. Në bazë të vlerësimeve të veta si dhe gjykimeve të juristëve të jashtëm, drejtimi është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale nga çështja dhe rrjedhimisht asnjë provizion nuk është regjistruar në këto pasqyra financiare.

37. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Asnjë ngjarje tjetër e rëndësishme nuk është identifikuar pas datës së bilancit që mund të kërkojë rregullim ose dhënie informacionesh shpjeguese në informacionin financiar.